

L I G J

PËR KËSHILLAT KOMBËTARE TË PAKICAVE KOMBËTARE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kompetencat e këshillave kombëtare të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejme: këshillat kombëtare) në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe të alfabeteve, procedura e zgjedhjes së këshillave kombëtare, financimi i tyre dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e këshillave kombëtare.

Neni 2

Për realizimin e të drejtave për vetëqeverisje në kulturë, arsim, informim dhe për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe alfabeteve, pjesëtarët e pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë mund të zgjedhin këshillat e veta kombëtare.

Këshilli Kombëtar e përfaqëson pakicën kombëtare në fushën e arsimit, kulturës, informimit në gjuhën e pakicës kombëtare dhe në përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit, merr pjesë në procesin e vendimmarrjes ose vendos për çështjet nga këto fusha dhe themelon institucione, shoqëri ekonomike dhe organizata tjera nga këto fusha.

Neni 3

Ministria kompetente për çështjet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave (në tekstin e mëtejme: Ministria) e mban regjistrin e këshillave kombëtare.

Regjistrimi në regjistër bëhet në bazë të kërkesës për regjistrim, të cilën e paraqet kryetari i Këshillit Kombëtar brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e konstituimit të këshillit.

Me regjistrimin në regjistër Këshilli Kombëtar e fiton të drejtën e personit juridik.

Neni 4

Regjistrimi në regjistër bëhet brenda afatit prej 30 ditësh nga data e marrjes së kërkesës së rregullt.

Në regjistër shënohet: emërtimi dhe selia e Këshillit Kombëtar, emri dhe mbiemri, numri unik i amzës dhe vendqëndrimi i kryetarit të Këshillit Kombëtar, data e miratimit të statutit, përkatësisht ndryshimi dhe plotësimi i statutit, numri dhe data e aktvendimit për regjistrim në regjistër.

Të dhënat e regjistruara në regjistër janë publike.

Ministria më hollësisht e rregullon përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit.

Neni 5

Këshilli Kombëtar mundet të fitojë dhe të tjetërsojë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, kurse në bazë të vendimit të organit kompetent mundet të jetë edhe shfrytëzues i mjeteve në pronën publike, në pajtim me ligjin.

Neni 6

Këshilli Kombëtar ka statut.

Me statut rregullohen:

- 1) veprimtaria e Këshillit Kombëtar;
- 2) numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar, në pajtim me ligjin;
- 3) selia e Këshillit Kombëtar;
- 4) emërtimi, simboli dhe vula e Këshillit Kombëtar;
- 5) numri dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të organeve të Këshillit Kombëtar;
- 6) organizmat tjerë të Këshillit Kombëtar, numri i anëtarëve dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organizmave;
- 7) mirënjohjet dhe mënyra e ndarjes së tyre, dhe
- 8) çështjet tjera me rëndësi për punën e Këshillit Kombëtar.

Këshilli Kombëtar ka për detyrë që, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e miratimit të ndryshimeve dhe të plotësimeve të statutit, të njoftojë për këtë Ministrinë dhe të dërgojë ndryshimet dhe plotësimet e statutit, si edhe procesverbalin nga seanca në të cilën janë aprovuar.

II. ÇËSHTJET STATUTORE TË KËSHILLIT KOMBËTAR

1. Organet e Këshillit Kombëtar

Neni 7

Këshilli Kombëtar e ka kryetarin, organin ekzekutiv, këshillat për arsim, kulturë, informim dhe për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit.

Me statut mund të përcaktohen organizmat konsultativë dhe organizmat tjerë të Këshillit Kombëtar.

Kryetari i Këshillit Kombëtar e përfaqëson Këshillin Kombëtar.

Kryetari i Këshillit Kombëtar zgjedhet nga radha e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Puna e Këshillit Kombëtar është publike.

Neni 8

Këshilli Kombëtar vendos me vlerë të plotë nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Statuti i Këshillit Kombëtar është aprovuar nëse për të votojnë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Kryetari i Këshillit Kombëtar dhe kryetari i organit ekzekutiv i Këshillit Kombëtar janë zgjedhur nëse për ta kanë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Vendimet tjera të Këshillit Kombëtar i miraton me shumicën e anëtarëve të pranishëm, nëse me statut nuk përcaktohet shumica e kualifikuar.

2. Numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar

Neni 9

Këshilli Kombëtar i ka më së paku 15, e më së shumtë 35 anëtarë.

Në rastin e pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i vogël se 10.000 persona ose veçanërisht nuk është shprehur, Këshilli Kombëtar i numëron 15 anëtarë.

Në rastin e pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 10.000 por më i vogël se 20.000 persona, Këshilli Kombëtar i numëron 19 anëtarë.

Në rastin e pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është midis 20.000 dhe 50.000 persona, Këshilli Kombëtar i numëron 23 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultatit të regjistrimit të fundit të popullsisë është midis 50.000 dhe 100.000 persona, Këshilli Kombëtar i numëron 29 anëtarë.

Në rast të pakicës kombëtare numri i së cilës sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 100.000 persona, Këshilli Kombëtar i numëron 35 anëtarë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar zgjat katër vjet.

Mandati i legjislativës së parë të Këshillit Kombëtar fillon nga data e regjistrimit në regjistrin e këshillave kombëtare.

III. KOMPETENCAT E KËSHILLIT KOMBËTAR

1. Kompetencat e përgjithshme

Neni 10

Këshilli Kombëtar, në pajtim me ligjin dhe me statutin e vet, përmes organeve të veta në mënyrë të pavarur:

- 1) miraton dhe ndryshon statutin e Këshillit Kombëtar;
- 2) miraton planin financiar, raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare;
- 3) disponon me pronën e vet;
- 4) vendos për emërtimin, simbolet dhe vulën e Këshillit Kombëtar;
- 5) përcakton propozimet e simboleve kombëtare, shenjave dhe festave të pakicës kombëtare;
- 6) themelon institucione, shoqata, fondacione, shoqëri ekonomike në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe alfabetit dhe në fushat tjera me rëndësi për ruajtjen e identitetit të pakicës kombëtare;
- 7) propozon përfaqësuesin e pakicës kombëtare në Këshillin për marrëdhënie ndërnacionale në njësinë e vetëqeverisjes vendore;
- 8) përcakton dhe ndan mirënjohje;

- 9) inicon miratimin dhe e përcjell zbatimin e ligjit dhe të akteve tjera nga fusha e kulturës, arsmi, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;
- 10) merr pjesë në përgatitjen e dispozitave dhe propozon ndryshimin dhe plotësimin e akteve me të cilat rregullohen të drejtat e garantuara me Kushtetutë të pakicave kombëtare në fushën e kulturës, arsmi, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit;
- 11) propozon akte të veçanta dhe masa të përkohshme në fushat në të cilat realizohet e drejta për vetëqeverisje, për arritjen e barazisë së plotë midis pjesëtarëve të pakicës kombëtare dhe qytetarëve të cilët i takojnë shumicës;
- 12) inicon procedurën para Gjykatës Kushtetuese, Mbrojtësit të qytetarëve, ombudsmanit krahinor dhe vendor dhe organeve tjera kompetente, kur vlerëson se është bërë shkelja e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj e pjesëtarëve të pakicave kombëtare;
- 13) inicon procedurën nga pika 12) e këtij neni në emër të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, bashkë me autorizimin e mëparshëm të marrë me shkrim;
- 14) merr qëndrimet, fillon nisma dhe ndërmerr masat lidhur me të gjitha çështjet të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti me pozitën, identitetin dhe të drejtat e pakicës kombëtare;
- 15) vendos për çështjet tjera të cilat i janë besuar me ligj, me aktin e krahinës autonome ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Kompetencat në fushën e arsimit

Të drejtat themeluese

Neni 11

Këshilli Kombëtar mundet, në pajtim me ligjin, të themelojë institucionet e edukimit, arsimit, standardit të nxënësve dhe të studentëve dhe të zbatojë të drejtat dhe obligimet e themeluesit.

Institucionet nga paragrafi 1, i këtij neni Këshilli Kombëtar i themelon në mënyrë të pavarur ose bashkë me Republikën, Krahinën Autonome, njësinë e vetëqeverisjes vendore ose me personin tjetër juridik në pajtim me ligjin.

Republika, Krahina autonome dhe njësia e vetëqeverisjes vendore si themeluese të institucioneve nga paragrafi 1, i këtij neni munden në tërësi ose pjesërisht të bartin të drejtat themeluese në Këshillin Kombëtar.

Pjesëmarrja në administrimin e institucioneve

Neni 12

Në institucionet e edukimit dhe të arsimit parashkollor, dhe të arsimit dhe të edukimit fillor dhe të mesëm themelues i të cilit është Republika, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, në të cilat puna arsimoro-edukative zhvillohet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare, ose në të cilat mësohet të folurit, gjuha ose kultura e pakicës kombëtare si lëndë e veçantë mësimore, Këshilli Kombëtar:

- 1) jep mendimin për kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit administrativ, përkatësisht shkollor – përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- 2) në institucione në të cilat në shumicën e paraleleve puna arsimoro-edukative zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare ose për të cilën është përcaktuar se janë me rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare, propozon anëtarët e këshillit administrativ, përkatësisht shkollor – përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- 3) jep mendimin për kandidatin për drejtor të institucionit nga paragrafi 1, pika 1) e këtij neni;
- 4) jep mendimin në procedurën e shkarkimit të drejtorit dhe të anëtarëve të organit të administrimit në institucionet nga paragrafi 1, pikat 1) dhe 2) të këtij neni;
- 5) jep pëlqimin e mëparshëm për zgjedhjen e drejtorit të institucionit nga paragrafi 1. pika 2) e këtij neni.

Në institucionet për standardin e nxënësve dhe të studentëve themelues i të cilave është Republika, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, Këshill Kombëtar:

- 1) propozon një anëtar – përfaqësuesin e themeluesve dhe e jep mendimin për kandidatët tjerë për anëtarë të këshillit administrativ të institucioneve për standardin e nxënësve, selia e të cilit është në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në të cilën gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar. Nëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore janë më shumë gjuhë të pakicave kombëtare në përdorim zyrtar, këshillat e interesuara kombëtare propozojnë kandidatin e përbashkët për anëtar të këshillit administrativ;
- 2) jep mendimin për kandidatët për anëtarë të këshillave administrative për institucionet për standardin e studentëve selia e të cilave është në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në të cilën gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar;
- 3) e jep mendimin në procedurën e zgjedhjes së drejtorit të institucionit për standardin e nxënësve dhe të studentëve selia e të cilit është në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në të cilën gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar;
- 4) jep mendimin në procedurën e shkarkimit të drejtorit dhe të anëtarëve të organeve të administrimit nga paragrafi 2 pikat 1) deri 3) të këtij neni.

Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare gjuha e të cilit nuk është në përdorim zyrtar në asnjë njësi të vetëqeverisjes vendore ka të drejta nga paragrafi 2, pikat 1) deri 4) të këtij neni në njësinë e vetëqeverisjes vendore në të cilën pjesëtarët e pakicës kombëtare të cilën ai e përfaqëson e përbëjnë më shumë se 1% të popullsisë së përgjithshme sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë.

Në fushën e arsimit të lartë në institucione themelues i të cilave është Republika, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, Këshilli Kombëtar e jep mendimin për kandidatët e propozuar për organet e udhëheqjes dhe të administrimit të institucionit të lartë shkollor në të cilin mësimi në tërësi ose pjesërisht zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare.

Plan-programet mësimore

Neni 13

Këshilli Kombëtar:

- 1) propozon Këshillit Arsimor Kombëtar bazat e përgjithshme të programit parashkollor, plan-programet mësimore për arsimin dhe edukimin fillor dhe të mesëm dhe bazat e programit edukativ, për përmbajtjet të cilat e shprehin veçantinë e pakicës kombëtare, e sidomos nga fusha e historisë, edukimit muzikor dhe artit figurativ;
- 2) i propozon Këshillit Kombëtar për Arsim programin e arsimit dhe të edukimit fillor dhe të mesëm për gjuhën e pakicës kombëtare dhe gjuhën përkatësisht të folurit, e pakicës kombëtare me elementet e kulturës kombëtare;
- 3) ia jep mendimin Këshillit Arsimor Kombëtar për programet mësimore të gjuhës serbe, si gjuhë joamtare;
- 4) i propozon ministrit kompetent për çështjet e arsimit masat dhe programin e punës edukative me nxënësit në institucionet për standardin e nxënësve, të cilat kanë të bëjnë me afirmimin e tolerancës ndëertrike dhe multikulturalizmit;
- 5) jep mendimin për programin shkollor dhe edukativ të institucioneve për të cilat është përcaktuar se janë me rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare.

Tekstet dhe mjetet mësimore

Neni 14

Nëse puna arsimoro-edukative realizohet në gjuhën e pakicës kombëtare, Këshilli Arsimor Kombëtar i propozon ministrit kompetent për çështjet e arsimit dhënien e lejes për shfrytëzimin e teksteve mësimore dhe të mjeteve mësimore përmbajtjet e të cilave i shprehin veçantitë e pakicës kombëtare bashkë me pëlqimin e mëparshëm të Këshillit Kombëtar.

Ministri kompetent për çështjet e arsimit e jep lejen për përdorimin e teksteve mësimore të vendit ose teksteve mësimore të importuara në gjuhën e pakicës kombëtare në punën arsimoro-edukative, me propozimin e Këshillit Kombëtar.

Kompetencat tjera në fushën e arsimit

Neni 15

Këshilli Kombëtar në pajtim me ligjin:

- 1) propozon një kandidat për listën e përbashkët të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Arsimor Kombëtar;
- 2) jep mendimin në procedurën e miratimit të aktit për rrjetin e institucioneve parashkollore dhe shkollave fillore në njësinë e vetëqeverisjes vendore në të cilën është në përdorim zyrtar gjuha e pakicës kombëtare ose në të cilën puna arsimoro-edukative zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 3) përcakton institucionet arsimoro-edukative me rëndësi të veçantë për arsimin e pakicës kombëtare; nëse numri i përgjithshëm i institucioneve është më i madh se katër, për institucionet me rëndësi të veçantë mund të shpallet më së shumti një e katërta nga numri i përgjithshëm i

institucioneve në të cilat mësimi zhvillohet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare; nëse numri i përgjithshëm i institucioneve të tilla është më i vogël se katër, institucion me rëndësi të veçantë mund të shpallet një nga institucionet në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare, përkatësisht edhe në gjuhën e pakicës kombëtare; në rastin e pakicës kombëtare në gjuhën e së cilës nuk zhvillohet mësimi, rregullat nga kjo pikë aplikohen për institucionet në të cilat mësohet gjuha ose të folurit me elementet e kulturës së pakicës kombëtare;

- 4) jep mendimin ministrit kompetent për çështjet e arsimit në procedurën e përcaktimit të rrjetit të shkollave të mesme dhe institucioneve për standardin e nxënësve dhe të studentëve;
- 5) jep mendimin ministrit kompetent për çështjet e arsimit në procedurën e dhënies së pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë së shkollës jashtë selisë së shkollës në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 6) i propozon themeluesit, Republikës, Krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes vendore pavarësimin e paraleles së ndarë të shkollës në të cilën zhvillohet mësimi në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 7) jep mendimin në procedurën e përcaktimit të numrit të nxënësve për regjistrim në shkollë të mesme, si edhe në procedurën e dhënies së pëlqimit për numrin e nxënësve për fitimin e aftësisimit profesional, rikualifikimit, përkualifikimit dhe specializimit;
- 8) ia jep mendimin ministrit kompetent për çështjet e arsimit në procedurën e dhënies së pëlqimit për hapjen e paraleles në gjuhën e pakicës kombëtare për më pak se 15 nxënës;
- 9) institucioneve për standardin e nxënësve dhe të studentëve ua jep mendimin për procedurën e ndarjes së vendeve në këto institucione;
- 10) jep mendimin në procedurën e ndarjes së mjeteve nga buxheti i Republikës, Krahinës autonome dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore të cilat u ndahen me anë të konkursit publik institucioneve dhe shoqatave në fushën e arsimit;
- 11) përcakton bursat nga mjetet vetjake dhe me aktet e veta i parashikon kriteret dhe procedurën e vendimmarrjes për ndarjen e bursave dhe e zbaton procedurën për ndarje;
- 12) përcakton përfaqësuesin në Këshillin Arsimor Kombëtar i cili merr pjesë në punën e tij pa pasur të drejtë për vendimmarrje, kur në gjuhën e pakicës kombëtare zhvillohet mësimi në kuadër të sistemit të arsimit, kurse kur Këshilli Arsimor Kombëtar i shqyrton çështjet me rëndësi për arsimin e pakicës kombëtare;
- 13) përcakton përfaqësuesin e vet në Këshillin Kombëtar për Arsim të lartë i cili është anëtar me të drejta të plota i këtij këshilli kur në gjuhën e pakicës kombëtare në tërësi ose pjesërisht zhvillohet mësimi në kuadër të arsimit të lartë;
- 14) Ushtron edhe punë të tjera nga kjo fushë të përcaktuara me ligj ose me akte të tjera.

3. Kompetencat në fushën e kulturës

Të drejtat themeluese

Neni 16

Këshilli Kombëtar mundet, në pajtim me ligjin, të themelojë institucionet e kulturës për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin e veçantisë kulturore dhe ruajtjen e identitetit kombëtar të pakicës kombëtare dhe të ushtrojë të drejtat dhe detyrat e themeluesit.

Institucionet nga paragrafi 1, i këtij neni Këshilli Kombëtar i themelon në mënyrë të pavarur ose bashkë me Republikën, Krahinën autonome, njësinë e vetëqeverisjes vendore ose me personin tjetër juridik, në pajtim me ligjin.

Republika, Krahina autonome dhe njësia e vetëqeverisjes vendore si themeluese të institucioneve nga paragrafi 1, i këtij neni munden në tërësi ose pjesërisht të bartin të drejtat themeluese në Këshillin Kombëtar.

Pjesëmarrja në administrimin e institucioneve

Neni 17

Në institucionet e kulturës themelues i të cilave është Republika, Krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore, për të cilat Këshilli Kombëtar përfundon se janë me rëndësi të veçantë për ruajtjen e identitetit të pakicës kombëtare, Këshilli Kombëtar:

- 1) emëron një anëtar të këshillit administrativ të institucionit;
- 2) jep mendimin për anëtarët e propozuar të këshillit administrativ të institucionit;
- 3) jep mendimin në procedurën e zgjedhjes së drejtorit të institucionit.

Nëse më shumë këshilla kombëtare konstatojnë se ndonjë institucion në fushën e kulturës është me rëndësi të veçantë për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin e veçantisë dhe të identitetit kombëtar të pakicës kombëtare, këshillat kombëtare e emërojnë nga një anëtar të këshillit administrativ nga paragrafi 1, pika 1) e këtij neni.

Kompetencat tjera në fushën e kulturës

Neni 18

Këshilli Kombëtar:

- 1) përcakton cilat institucione dhe manifestime në fushën e kulturës janë me rëndësi të veçantë për ruajtjen, përparimin dhe zhvillimin e veçantisë dhe të identitetit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare;
- 2) përcakton strategjinë e zhvillimit të kulturës së pakicës kombëtare;
- 3) përcakton cilat janë të mirat kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme me rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare;
- 4) fillon procedurën para organit kompetent ose institucionit për përcaktimin e statusit për të mirat kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme të mbrojtura me ligj me rëndësi për pakicën kombëtare;
- 5) propozon ndërmarrjen e masave të mbrojtjes, riaftësimin dhe rikonstruktimin e të mirave materiale nga paragrafi 1, pika 4) e këtij neni;

- 6) jep mendimin dhe propozimet në procedurën e hartimit të planeve hapësinore dhe urbanistike në njësinë e vetëqeverisjes vendore në të cilën gjenden të mirat kulturore nga paragrafi 1, pika 3) e këtij neni;
- 7) propozon ndaljen e zbatimit të planeve hapësinore dhe urbanistike nëse konsideron se me këtë rrezikohen të mirat kulturore nga paragrafi 1, pika 3) e këtij neni;
- 8) ia jep mendimin paraprak organit kompetent në procedurën e dhënies së lejes për zhvendosjen e të mirave kulturore të paluajtshme nga paragrafi 1, pika 3) e këtij neni në vendndodhje të re;
- 9) jep mendimin në procedurën e themelimit ose të mbylljes së bibliotekave ose të njërive oraganizuese të bibliotekave të cilat e kanë fondin e librave në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 10) jep propozimin për ndarjen e mjeteve të cilat ndahen përmes konkursit publik nga buxheti i Republikës, Krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes vendore institucioneve, manifestimeve dhe shoqatave të pakicës kombëtare në fushën e kulturës;
- 11) propozon më së paku një kandidat për listën e përbashkët të kandidatëve për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar për kulturë;
- 12) përcakton përfaqësuesin e vet në Këshillin Kombëtar për kulturë i cili, pa të drejta për vendimmarrje, merr pjesë në punën e tij kur shqyrtohen çështjet me rëndësi për kulturën e pakicës kombëtare;
- 13) vendos për çështjet tjera të cilat i janë besuar me ligj, aktin e krahinës autonome ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Kompetencat në fushën e informimit

Të drejtat themeluese

Neni 19

Këshilli Kombëtar mundet, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, në mënyrë të pavarur ose bashkë me personin tjetër juridik, të themelojë institucione dhe shoqëri ekonomike për ushtrimin e veprimtarisë gazetaro-botuese dhe radiotelevizive, shtypjes dhe riprodhimit të mediave të incizuara ose të ushtrijë të drejtat dhe obligimet e themeluesit.

Republika, Krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore si themelues i ndërmarrjeve dhe institucioneve publike në fushën e informimit publik të cilat në tërësi ose kryesisht e ushtrijë informimin në gjuhën e pakicës kombëtare munden në marrëveshje me Këshillin Kombëtar në tërësi ose pjesërisht të bartin të drejtat themeluese në Këshillin Kombëtar.

Pjesëmarrja në administrimin e institucioneve

Neni 20

Këshilli Kombëtar:

- 1) jep mendimin në procedurën e emërimit të anëtarëve të këshillit administrativ, këshillit programor dhe të drejtorit të përgjithshëm të Institucionit Radiopërhapës të Serbisë, nëse ky institucion e emiton programin në gjuhën e pakicës kombëtare;

- 2) jep mendimin në procedurën e emërimit të anëtarëve të Këshillit administrativ, këshillit programor dhe drejtorit të përgjithshëm të Institucionit Radipërhapës të Vojvodinës, nëse ai institucion emiton programin në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 3) përcakton kriteret për zgjedhjen e kryeredaktorit përgjegjës të programit në gjuhën e pakicës kombëtare në institucionin e shërbimit publik;
- 4) propozon këshillit drejtues të institucionit radiopërhapës emërimin e kryeredaktorit përgjegjës të programit në gjuhën e pakicës kombëtare nga kandidatët të cilët paraqiten dhe i plotësojnë kushtet e konkursit;
- 5) jep mendimin për kandidatët për kryeredaktor përgjegjës të programit në gjuhët e pakicave kombëtare në institucionin radipërhapës në të cilin emërohet kryeredaktori përgjegjës për më shumë programe në gjuhët e pakicave kombëtare.

Kompetencat tjera në fushën e informimit

Neni 21

Këshilli Kombëtar:

- 1) aprovon strategjinë e zhvillimit të informimit në gjuhën e pakicës kombëtare, në pajtim me strategjinë e Republikës së Serbisë;
- 2) i jep propozime Agjencisë Republikane për Radiopërhapje me rastin e hartimit të Strategjisë së zhvillimit për radiopërhapje;
- 3) jep propozimin për ndarjen e mjeteve të cilat ndahen me anë të konkursit publik nga buxheti i Republikës, Krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes vendore personave juridikë dhe fizikë të cilët e ushtrojnë informimin në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 4) i shqyrton raportet e Këshillit administrativ dhe programor të Institucionit Radiopërhapës të Serbisë dhe të Institucionit Radipërhapës të Vojvodinës dhe jep propozime dhe rekomandime për programet në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 5) jep mendime dhe propozime Këshillit të Agjencisë Republikane për Radipërhapje, lidhur me informimin në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 6) e cakton përfaqësuesin në Këshillin e Agjencisë Republikane për Radiopërhapje i cili merr pjesë në punën e tij pa të drejta për vendimmarrje, kur shqyrtohen çështjet lidhur me informimin në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 7) ushtron edhe punë të tjera nga kjo fushë të përcaktuara me ligj dhe me aktet e tjera.

5. Kompetencat në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit

Neni 22

Këshilli Kombëtar:

- 1) përcakton emërtimet tradicionale të njësisë së vetëqeverisjes vendore, vendbanimeve dhe emërtimeve tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare, nëse në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose vendbanimit gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar; emërtimet të cilat i ka përcaktuar Këshilli Kombëtar bëhen emërtime në

përdorim zyrtar pranë emërimit në gjuhën serbe dhe shpallen në “Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë”, kurse në rastin e këshillave kombëtare selia e të cilëve është në territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës në “Fletoren zyrtare të Krahinës Autonome të Vojvodinës”;

- 2) i propozon organit kompetent theksimin e emërimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, vendbanimeve dhe emërtimeve tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare;
- 3) propozon përcaktimin e gjuhës dhe të alfabetit të pakicës kombëtare si gjuhë dhe alfabet zyrtar në njësinë e vetëqeverisjes vendore;
- 4) propozon ndryshimin e emërimit të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, lagjeve të fshatit, pjesëve tjera të vendbanimeve dhe institucionve për të cilat është konstatuar se janë me rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare;
- 5) jep mendimin në procedurën e përcaktimit të emërtimeve të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, lagjeve të fshatit dhe pjesëve tjera të vendbanimeve, nëse në përdorim zyrtar në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose vendbanimit është gjuha e pakicës kombëtare;
- 6) propozon organit kompetent ushtrimin e mbikëqyrjes mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të gjuhës kombëtare;
- 7) u propozon organeve kompetente masat dhe aktivitetet për përparimin e përkthimit të akteve në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar;
- 8) ndërmerr masa dhe aktivitete për përparimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të pakicës kombëtare;
- 9) vendos për çështjet tjera nga kjo fushë të cilat i janë besuar me ligj, aktin e krahinës autonome ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

6. Zhvlerësimi i akteve juridike

Neni 23

Aktet individuale juridike nga neni 12 deri 15, nenet 17 dhe 18 dhe nenet 20 deri 22 të këtij ligji të cilat janë miratuar pa propozimet ose mendimet përkatëse të Këshillit Kombëtar janë kundërligjore, përkatësisht të pavlefshme.

Nëse Këshilli Kombëtar edhe krahas kërkesës së paraqitur nga organi kompetent, brenda afatit prej 30 ditësh nuk e dorëzon propozimin ose mendimin, akti nga paragrafi 1, i këtij neni miratohet edhe pa marrjen e propozimit, përkatësisht mendimit.

7. Bartja e të drejtave themeluese

Neni 24

Me nismën e Këshillit Kombëtar, Republika e Serbisë, Krahinë autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore i bart në tërësi ose pjesërisht të drejtat mbi:

- 1) institucionet arsimoro-edukative në të cilat mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën e pakicës kombëtare;

- 2) institucionet e kulturës veprimtaria themelore e të cilave është ruajtja dhe zhvillimi i kulturës së pakicës kombëtare;
- 3) institucionet të cilat e kryejnë informimin publik vetëm në gjuhën e pakicës kombëtare.

Me nismën e Këshillit Kombëtar, Republika e Serbisë, Krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes vendore në tërësi ose pjesërisht i bart të drejtat themeluese mbi institucionet të cilat nuk janë përfshirë me pikat 1) deri 3) paragrafi 1, i këtij neni nëse janë me rëndësi të veçantë për pakicën kombëtare.

Organet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni me Këshillin Kombëtar e lidhin kontratën për bartjen e të drejtave themeluese në tërësi ose pjesërisht (në tekstin e mëtejshëm: kontrata).

Kontrata përmban të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të organit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe të Këshillit Kombëtar.

Kontrata i rregullon të drejtat e administrimit të cilat barten dhe vëllimin vjetor të mjeteve të cilat sigurohen në buxhetin e Republikës, Krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes vendore për financimin e veprimtarisë së institucionit.

Në pikëpamje të financimit buxhetor, pozita materiale e institucioneve të drejtat themelore të të cilave barten në tërësi ose pjesërisht nuk mund të jetë më e pavolitshme në krahasim me institucionin të drejtat themelore të të cilëve nuk barten në Këshillin Kombëtar.

IV. RAPORTI ME ORGANET REPUBLIKANE, ORGANET E KRAHINËS AUTONOME DHE ORGANET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Raporti me organet republikane

Neni 25

Këshilli Kombëtar mundet t'ia paraqesë Kuvendit Popullor, Qeverisë dhe organeve tjera shtetërore dhe organizatave të veçanta propozimet, nismat dhe mendimet për çështjet nga kompetenca e vet.

Para shqyrtimit dhe vendimmarrjes për çështjet nga fushat nga neni 2, të këtij ligji, organet nga paragrafi 1, i këtij neni do të kërkojnë mendimin e këshillave kombëtare.

Procedura e marrjes së mendimit do të rregullohet sipas rregulloreve të punës së organeve nga paragrafi 1, i këtij neni.

Këshilli Kombëtar mundet t'ia paraqesë nismën qeverisë për suprimimin, përkatësisht anulimin e akteve të organeve shtetërore dhe të organizatave të veçanta, të cilat nuk janë në pajtim me aktet e këtij ligji dhe me ligjet dhe aktet tjera të cilat kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

Raporti me organet e krahinës autonome dhe me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Neni 26

Këshillat kombëtare i japin propozimet, nismat dhe mendimet për çështjet të cilat kanë të bëjnë me pozitën e pakicave kombëtare dhe me ruajtjen e veçantive të

pakicave kombëtare, organeve të krahinave autonome dhe organeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Organet e krahinës autonome, përkatësisht njësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë për detyrë të shqyrtojnë propozimet, nismat dhe mendimet e këshillave kombëtare dhe të ndërmarrin masat përkatëse.

Në procedurën e miratimit të akteve të përgjithshme nga fushat të cilat janë theksuar në nenin 2, të këtij ligji, organet e krahinës autonome, përkatësisht të njësisë së vetëqeverisjes vendore, do të kërkojnë mendimin e këshillave kombëtare.

Procedura e marrjes së mendimeve do të rregullohet sipas rregulloreve të punës së organeve nga paragrafi 1, i këtij neni.

V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL

Neni 27

Këshilli Kombëtar, në pajtim me ligjin, bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, me organet shtetërore, organizatat dhe institucionet në shtetet amë, si edhe me këshillat kombëtare ose organizmat e ngjashëm të pakicave kombëtare në shtetet tjera.

Përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar marrin pjesë në biseda ose këshillohen lidhur me bisedat për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale me shtetet amë, në pjesën e cila ka të bëjë drejtpërsëdrejti me të drejtat e pakicave kombëtare.

Përfaqësuesit e këshillave kombëtare marrin pjesë në punën e organizmave të përzier ndërshtetëror detyra e të cilëve është të mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjeve bilaterale ndërshtetërore për mbrojtjen e të drejtave të një pakice të caktuar kombëtare.

Neni 28

Përfaqësuesit e pakicave kombëtare, përmes Këshillit të Republikës së Serbisë për pakicat kombëtare, marrin pjesë në procedurën e lidhjes, përkatësisht zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare ose rajonale të cilat kanë të bëjnë me pozitën dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare.

VI. ZGJEDHJA E KËSHILLAVE KOMBËTARE

1. Dispozitat e përbashkëta

Neni 29

Zgjedhjet për këshilla kombëtare mund të jenë të drejtpërdrejta ose përmes kuvendit elektoral.

Pakicat kombëtare do të orientohen vetë se cilës prej këtyre dy mënyrave do t'i japin përparësi.

Zgjedhjet e drejtpërdrejta për këshilla kombëtare do të mbahen nëse deri në ditën e shpalljes së zgjedhjeve, në listë të veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare, regjistrohen më shumë se 50% nga numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të pakicës kombëtare sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, i zvogëluar për 20%.

Parimet e zgjedhjes së këshillave kombëtare

Neni 30

Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bazohen në parimet e lirisë së zgjedhjes, barazisë së të drejtës elektorale, periodicitetit dhe parimit të votimit të fshehtë.

Parimet e veçanta të zgjedhjeve janë vullneti, përpjesëtimi dhe demokraticiteti.

E drejta elektorale

Neni 31

E drejta elektorale e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për zgjedhjen e këshillave kombëtare i përfshin të drejtat e pjesëtarëve të pakicës kombëtare që: të zgjedhë anëtarët e Këshillit Kombëtar, të zgjedhet për anëtar të Këshillit Kombëtar, të propozojë kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar, të jetë i informuar për zgjedhjet për këshillat kombëtare, për kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar, si edhe për programet e tyre, të jetë i regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare, të votojë për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar dhe të drejtën për mbrojtjen e të drejtave që kanë të bëjnë me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar.

E drejta aktive elektorale

Neni 32

Pjesëtari i pakicës kombëtare e fiton të drejtën të zgjedhë anëtarët e Këshillit Kombëtar nëse i plotëson kushtet e përgjithshme të parashikuara me Kushtetutë dhe me ligj për fitimin e të drejtës elektorale.

Kusht i veçantë për fitimin e të drejtës aktive elektorale për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të anëtarëve të Këshillit Kombëtar është regjistrimi në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Kusht i veçantë për fitimin e të drejtës aktive të zgjedhësve për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare përmes kuvendit elektoral është statusi i elektorit, i cili fitohet sipas dispozitave të këtij ligji.

E drejta pasive elektorale

Neni 33

Për anëtar të Këshillit Kombëtar mund të zgjedhet pjesëtari i pakicës kombëtare i cili i plotëson kushtet nga neni 32, i këtij ligji dhe nuk e ushtron funksionin e gjykatësit, prokurorit ose të gjykatësit të Gjykatës kushtetuese.

Dispozitat e veçanta për votim

Neni 34

Votimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar organizohet vetëm në territorin e Republikës së Serbisë.

Shpallja e zgjedhjeve

Neni 35

Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për Këshill Kombëtar e merr ministri kompetent për çështjet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave (në tekstin e mëtejme: ministri).

Vendimi për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar merret jo më vonë herët se 120 ditë, dhe jo më vonë se 90 ditë para skadimit të mandatit të Këshillit Kombëtar.

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve përmban: mënyrën e zgjedhjes, numrin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili zgjedhet, dispozitat për fillimin e afateve për veprimet zgjedhore dhe ditën në të cilën mbahet votimi.

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Koha për mbajtjen e zgjedhjeve

Neni 36

Zgjedhjet për anëtarë të të gjitha këshillave kombëtare mbahen në të njëjtën kohë.

Zgjedhjet duhet të përfundojnë më së voni 15 ditë para skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur anëtarët e Këshillit Kombëtar.

Shpenzimet dhe taksat

Neni 37

Parashtresat të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar dhe vulosja në gjykatë e nënshkrimeve nuk i nënshtrohen pagimit të taksave.

Mjetet financiare për zbatimin e zgjedhjeve të Këshillit Kombëtar sigurohen nga buxheti i Republikës së Serbisë.

Organizimi i zgjedhjeve

Neni 38

Të gjitha punët e organizimit dhe të zbatimit të zgjedhjeve për këshilla kombëtare i ushtrojnë Ministria dhe organet për zbatimin e zgjedhjeve, në pajtim me këtë ligj.

Obligimet e mjeteve të informimit publik lidhur me zgjedhjet e këshillave kombëtare

Neni 39

Mjetet e informimit publik kanë për detyrë që, në pajtim me ligjin, të përcjellin rrjedhën e aktiviteteve zgjedhore dhe të raportojnë për zgjedhjet e këshillave kombëtare.

Për informimin lidhur me zgjedhjet e këshillave kombëtare aplikohen konform ligjet të cilat e rregullojnë informimin publik në procedurën zgjedhore.

Shpërndarja e Këshillit Kombëtar dhe organi i përkohshëm i administrimit

Neni 40

Ministria e shpërndan Këshillin Kombëtar nëse:

- 1) Këshilli Kombëtar nuk mban mbledhje më gjatë se gjashtë muaj;
- 2) nëse nuk e zgjedh kryetarin e Këshillit Kombëtar brenda afatit prej 60 ditësh nga data e konstituimit të Këshillit Kombëtar ose nga pushimi i funksionit të kryetarit;
- 3) nuk e miraton statutin brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj.

Aktvendimi i Ministrisë për shpërndarjen e Këshillit Kombëtar është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë procedura e mosmarrëveshjes administrative.

Deri te konstituimi i legjislaturës së re të Këshillit Kombëtar çështjet vijuese dhe të menjëhershme nga kompetenca dhe veprimtaria e Këshillit Kombëtar i ushtron organi i përkohshëm i Këshillit Kombëtar të cilin e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë.

Ministria, nga radha e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, me aktvendim e formon organin e përkohshëm, duke pasur kujdes për përfaqësimin e listave të zgjedhësve nga të cilat janë zgjedhur anëtarët e Këshillit Kombëtar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe pushimi i anëtarësisë në Këshillin Kombëtar

Neni 41

Anëtarët e Këshillit Kombëtar zgjedhen për periudhën prej katër vitesh dhe mund të rizgjedhen për të njëjtën pozitë.

Anëtarit të Këshillit Kombëtar i pushon anëtarësia në Këshillin Kombëtar para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur:

- 1) me dhënien e dorëheqjes;
- 2) me hyrjen në punë ose marrjen e funksionit i cili nuk është bashkëlidhës me anëtarësinë në Këshillin Kombëtar;
- 3) me humbjen e njërit prej kushteve për fitimin e së drejtës aktive të zgjedhësve;
- 4) nëse ka më shumë se një vit që nuk merr pjesë në punën e Këshillit Kombëtar;
- 5) në rast të vdekjes;
- 6) nëse i pushon vendqëndrimi në territorin e Republikës së Serbisë;
- 7) nëse me vendimin definitiv të organit kompetent është shlyer nga lista e veçantë e zgjedhësve e pjesëtarit të pakicës kombëtare, nëse Këshilli Kombëtar është zgjedhur drejtpërsëdrejti;
- 8) nëse me aktgjykimin e plotëfuqishëm është dënuar për vepër penale me dënimin me burg në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj.

Ditën e pushimit të anëtarësisë në Këshillin Kombëtar e konstaton Këshilli Kombëtar në seancën e parë të ardhshme pas pranimit të njohtimit për krijimin e shkaqeve për pushimin e anëtarësisë në Këshillin Kombëtar.

Kur anëtarit të Këshillit Kombëtar i pushon mandati, vendin e tij në Këshillin Kombëtar e merr kandidati nga lista e zgjedhësve në të cilën ka qenë anëtar i listës së cilit i ka pushuar mandati, e të cilin e emëron propozuesi i listës.

Thirrja e seancës së parë e Këshillit Kombëtar

Neni 42

Brenda afatit prej 30 ditësh nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, ministri e fton seancën konstitutive të këshillave kombëtare.

Aplikimi konform i ligjeve të tjera

Neni 43

Në zgjedhjen e Këshillit Kombëtar dhe në çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj, konformë aplikohen dispozitat e Ligjit për zgjedhjen e deputetëve të popullit, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe të Ligjit për procedurën për mosmarrëveshjen administrative.

2. Zgjedhjet e drejtpërdrejta të anëtarëve të këshillave kombëtare

Listat e zgjedhësve

Neni 44

Ministria e harton listën e veçantë të zgjedhësve për pakicat kombëtare të cilat deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji e kanë themeluar Këshillin Kombëtar.

Në rast se pakica kombëtare deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk e ka formuar Këshillin Kombëtar, procedura nga paragrafi 1, i këtij neni mundet të fillojë nëse, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, Ministria e pranon kërkesën e pjesëtarit ose organizatës së një pakice të tillë kombëtare, me kusht që kërkesa të jetë përkrahur me nënshkrimet e vulosura në gjykatë të më së paku 5% të pjesëtarëve të kësaj pakice kombëtare sipas regjistrimit të fundit të popullsisë. Ministria me aktvendim vendos për plotësimin e kushteve nga kërkesa.

Nëse pakica kombëtare orientohet për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar pas skadimit të afatit nga paragrafi 2, i këtij neni, që procedura e formimit të listës së veçantë të zgjedhësve të fillohet është e nevojshme që para shpalljes së zgjedhjeve të ardhshme Ministria ta marrë kërkesën e pjesëtarëve ose të organizatës së një pakice të tillë kombëtare, me kusht që kërkesa të jetë e mbështetur me nënshkrimet e vulosura në gjykatë të më së paku 5% të pjesëtarëve të kësaj pakice kombëtare sipas regjistrimit të fundit të popullsisë. Ministria me aktvendim vendos për plotësimin e kushteve nga kërkesa.

Aktvendimi i Ministrisë nga paragrafët 2 dhe 3, të këtij neni është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë mosmarrëveshja administrative.

Neni 45

Ministria përmes mjeteve të informimit publik i njohton të gjithë qytetarët për të drejtën elektorale, pjesëtarët e pakicave kombëtare nga neni 44, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, se formimi i listës së veçantë të zgjedhësve të pakicave kombëtare ka filluar.

Secili qytetar me të drejtë vote, pjesëtar i pakicës kombëtare nga neni 44, paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mundet në formular të veçantë me shkrim të

kërkojë që, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, të regjistrohet në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës përkatëse kombëtare.

Neni 46

Listën e parë të veçantë të zgjedhësve Ministria përkohësisht e mbyll 120 ditë pas ditës së shpalljes publike se formimi i listës së veçantë të zgjedhësve ka filluar dhe e përcakton numrin e përgjithshëm të zgjedhësve në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare.

Nëse në bazë të numrit të përcaktuar të zgjedhësve në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare janë plotësuar kushtet për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Këshillit Kombëtar nga neni 29 i këtij ligji, Ministria i shpall zgjedhjet në pajtim me nenin 35 të këtij ligji brenda afatit prej 15 ditësh nga skadimi i afatit nga paragrafi 1, i këtij neni.

Rregullat e përgjithshme për listën e veçantë të zgjedhësve të pakicave kombëtare

Neni 47

Lista e veçantë e zgjedhësve është dokument publik në të cilin mbahet evidenca e pjesëtarëve të pakicave kombëtare të cilët e kanë të drejtën e votimit.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare regjistrohen vullnetarisht në listën e veçantë të zgjedhësve.

Për secilën pakicë kombëtare mbahet lista e veçantë unike e zgjedhësve.

Pjesëtari i pakicës kombëtare mund të regjistrohet vetëm në një listë të veçantë të zgjedhësve.

Neni 48

Lista e veçantë e zgjedhësve mbahet sipas detyrës zyrtare.

Lista e veçantë e zgjedhësve është unike, e përhershme dhe azhurnohet rregullisht, dhe veçanërisht azhurnohet brenda afatit prej 15 ditësh nga data e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Neni 49

Të dhënat nga lista e veçantë e zgjedhësve e gëzojnë mbrojtjen e veçantë.

Ndalohet dhe është i dënueshëm secili shfrytëzim i të dhënave nga lista e veçantë e zgjedhësve, përveç me qëllim të zgjedhjes së Këshillit Kombëtar, si edhe për realizimin e të të drejtave të tjera të pakicave kombëtare, nëse kjo është parashikuar me ligj ose me aktin e krahinës autonome.

Neni 50

Lista e veçantë e zgjedhësve përmban: numrin rendor, emrin personal, numrin e amzës, gjininë, përkatësinë kombëtare, vitin e lindjes, vendqëndrimin (rruga dhe numri i shtëpisë, fshati, lagjja e fshatit, vendbanimi) dhe hapësirën për vërejtje.

Neni 51

Listën e veçantë të zgjedhësve e mban në mënyrë elektronike Ministria.

Listat e veçanta të zgjedhësve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore i mbajnë, si punë e besuar, administratat komunale, përkatësisht të qytetit në formë elektronike.

Lista e veçantë e zgjedhësve mbyllet me aktvendimin e Ministrisë më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 52

Pjesëtarët e pakicës kombëtare regjistrohen në listën e veçantë të zgjedhësve kur i plotësojnë kushtet e përgjithshme për fitimin e të drejtës së zgjedhësve të parashikuar me ligj.

Secili qytetar me të drejtë elektorale, pjesëtar i pakicës kombëtare, mundet në formular të veçantë të kërkojë me shkrim të jetë i regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve.

Kërkesën për regjistrim në listë të veçantë të zgjedhësve votuesi ia paraqet organit të administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas vendit të vendqëndrimit, në formën me shkrim, në formularë të veçantë të cilin e parashikon Ministria dhe e nënshkruan me dorën e vet.

Në listën e veçantë të zgjedhësve nuk mund të regjistrohen personat të cilëve me vendim të plotëfuqishëm u është hequr zotësia afariste për të vepruar. Nëse personat e tillë janë regjistruar në listën e zgjedhësve, do të shlyhen prej saj, dhe kur me vendim të plotëfuqishëm të gjykatës u kthehet zotësia afariste për të vepruar, përsëri regjistrohen në listën e zgjedhësve.

Secili korrigjim dhe ndryshim në listën e veçantë të zgjedhësve mund të bëhet vetëm me kërkesën personale të zgjedhësit.

Neni 53

Kërkesën për shlyerje nga lista e veçantë e zgjedhësve, zgjedhësi ia paraqet organit të administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas vendit të vendqëndrimit, në formën me shkrim, në formular të veçantë të cilin e parashikon Ministria dhe e nënshkruan me dorën e vet.

Zgjedhësi mundet të shlyhet nga lista e veçantë e zgjedhësve në rastet kur e humb të drejtën e votimit për shkak të mosplotësimit të njërës prej kushteve për fitimin e së drejtës së votimit të përcaktuara me ligj dhe me kërkesën e organit kompetent për mbajtjen e listës së veçantë të zgjedhësve duke i mbledhur dëshmitë nga evidencat zyrtare.

Organet të cilat e mbajnë evidencën zyrtare për qytetarët kanë për detyrë që organeve kompetente për mbajtjen e listave të votimit t'ua dërgojnë të dhënat të cilat ndikojnë në saktësinë dhe azhurnitetin e mbajtjes së listave të zgjedhësve.

Neni 54

Lista e veçantë e zgjedhësve dhe të dhënat të cilat shënohen në këtë listë mbahen njëkohësisht edhe në gjuhën serbe dhe në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare për të cilën mbahet lista e zgjedhësve.

Neni 55

Ministria e rregullon më hollësisht mënyrën e mbajtjes së listës së zgjedhësve dhe çështjet tjera të cilat janë të nevojshme për mbajtjen e plotë, të saktë dhe të azhurnuar të listave të zgjedhësve.

Neni 56

Nëse në procedurën e regjistrimit në listën e veçantë të zgjedhësve ose të shlyerjes nga lista, organi i administratës i njësisë së vetëqeverisjes vendore i cili e mban listën e zgjedhësve refuzon të bëjë regjistrimin e zgjedhësit në listën e veçantë të zgjedhësve ose shlyerjen nga lista, zgjedhësi ka të drejtë t'i paraqesë ankesë Ministrisë. Aktvendimi i Ministrisë është definitiv dhe kundër tij mund të fillojë procedura për mosmarrëveshjen administrative.

Ministria e miraton aktvendimin lidhur me ankesën brenda afatit prej 15 ditësh.

Neni 57

Pas mbylljes së listës së veçantë të zgjedhësve, regjistrimi, shlyerja, ndryshimet, plotësimet dhe korrigjimet mund të bëhen vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, në procedurën për mosmarrëveshjen administrative, më së voni dhjetë ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 58

Gjatë kohëzgjatjes së mandatit të të gjitha këshillave të zgjedhura kombëtare, pa e marrë parasysh mënyrën e zgjedhjeve, listat e veçanta të zgjedhësve azhurnohen rregullisht. Pjesëtarët e pakicave kombëtare të cilët i kanë zgjedhur këshillat kombëtare mund të kërkojnë nga organi kompetent që emri i tyre të regjistrohet në listë të veçantë të zgjedhësve ose të shlyhet nga lista e veçantë e zgjedhësve.

Ministria ka për detyrë që, para shpalljes së zgjedhjeve të ardhshme, të konstatojë cilat pakica kombëtare e kanë plotësuar kushtin që të mbahen zgjedhjet e drejtpërdrejta.

Neni 59

Mbikëqyrjen mbi aplikimin e dispozitave me të cilat rregullohet mbajtja e listave të veçanta të zgjedhësve në njësitë e vetëqeverisjes vendore e bën Ministria.

Nëse Ministria pohon se lista e veçantë e zgjedhësve nuk po mbahet sipas mënyrës së parashikuar me ligj dhe me dispozitat e miratuara në bazë të ligjit, do të urdhërojë organin kompetent të mënjanojë parregullsitë e konstatuara.

Organet për zbatimin e zgjedhjeve

Neni 60

Organet për zbatimin e zgjedhjeve të këshillave kombëtare janë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ), Komisioni Zgjedhor për Zonat Zgjedhore (në tekstin e mëtejme KZZ) dhe këshillat e zgjedhësve.

Kushtet për punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve i siguron Ministria.

Përbërja e Komisionit Qendror Zgjedhor

Neni 61

KQZ e përbëjnë anëtarët e përbërjes së përhershme dhe të zgjeruar.

Përbërjen e përhershme të KQZ e përbëjnë tre anëtarë të cilët i emëron ministri. Anëtarët e përbërjes së përhershme mund të jenë vetëm juristë të diplomuar.

Përbërjen e zgjeruar të KQZ e përbëjnë përfaqësuesit e propozuesit të listave të zgjedhësve. Dy ose më shumë propozues të listave të zgjedhësve mundën me marrëveshje të caktojnë përfaqësuesin e përbashkët në përbërjen e zgjeruar të KQZ.

Anëtarët nga përbërja e zgjeruar e KQZ me të drejta të plota marrin pjesë në punë dhe në vendimmarrje.

Anëtarët e përbërjes së përhershme të KQZ i kanë zëvendësit të cilët zgjedhen sipas mënyrës nga paragrafi 2, i këtij neni.

Në punën e KQZ merr pjesë kryetari i Entit Republikan për Statistikë, pa të drejtë për vendimmarrje.

Anëtarët e përbërjes së përhershme të KQZ e zgjedhin kryetarin dhe sekretarin e KQZ nga radhët e veta.

Kompetenca e Komisionit Qendror Zgjedhor

Neni 62

Kompetencat e KQZ janë:

- 1) kujdeset për zbatimin ligjor të zgjedhjeve;
- 2) organizon përgatitjen teknike për zgjedhje;
- 3) e përcjell aplikimin dhe jep sqarime lidhur me aplikimin e këtij ligji, lidhur me zgjedhjet e drejtpërdrejta të anëtarëve të këshillave kombëtare;
- 4) i përcakton standardet unike për material zgjedhor;
- 5) i përcakton formularët dhe rregullat për zbatimin e veprimeve zgjedhore të parashikuara me këtë ligj;
- 6) i përcakton zonat zgjedhore të cilat i përbëjnë territoret e një ose më shumë njësisive fqinje të vetëqeverisjes vendore dhe i shpall në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë";
- 7) përcakton dhe shpall në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë", numrin dhe adresën e qendrave të votimit, më së voni 20 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve;
- 8) emëron kryetarin, anëtarët dhe zëvendësit e përbërjes së përhershme të komisionit zgjedhor për zonën zgjedhore dhe për këshillat e zgjedhjeve;
- 9) e përcakton numrin e fletëvotimeve për qendrat e votimit, i vulos dhe bashkë me kopjen nga lista e zgjedhësve, me procesverbal, ua dorëzon komisioneve të zonave zgjedhore;
- 10) e përcakton a është hartuar dhe paraqitur lista e zgjedhësve, në pajtim me këtë ligj dhe e shpall listën e zgjedhësve;
- 11) e miraton aktvendimin për shpalljen e listave shumëemërore zgjedhore;

- 12) e përcakton mënyrën e ruajtjes dhe të veprimit me materialin e zgjedhjeve;
- 13) i përcakton dhe i shpall rezultatet e zgjedhjeve;
- 14) e përcakton numrin e mandateve të cilat i takojnë secilës liste të zgjedhjeve;
- 15) ia paraqet raportin Ministrisë dhe e njohton Kuvendin Popullor për zgjedhjet e zbatuara;
- 16) ua dërgon të dhënat organeve kompetente për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore;
- 17) ushtron edhe punë të tjera të parashikuara me këtë ligj.

KQZ e miraton rregulloren për punën e vet dhe rregullat për punën e KZZ dhe të këshillave të zgjedhësve.

KQZ ka për detyrë që formularët nga pika 5) e këtij neni t'ua lërë në disponim pjesëmarrësve në zgjedhje brenda afatit prej pesë ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.

Përbërja e Komisionit zgjedhor për zonën zgjedhore

Neni 63

Përbërjen e KZZ e përbëjnë kryetari dhe dy anëtarë të cilët i emëron KQZ me propozimin e propozuesit të listave zgjedhore.

Kryetari dhe anëtarët e KZZ i kanë zëvendësit të cilët emërohen në të njëjtën mënyrë si edhe anëtarët.

Kompetenca e Komisionit Zgjedhor për Zonat zgjedhore

Neni 64

KZZ e pranon materialin e zgjedhjeve nga KQZ dhe ua dërgon këshillave zgjedhore.

KZZ e pranon materialin e zgjedhjeve nga këshillat zgjedhore nga qendrat e votimit dhe ia dërgon KQZ-së.

Për pranimin dhe dërgimin e materialit zgjedhor hartohet procesverbali për dorëzim-pranim.

KZZ ushtron edhe punë të tjera të përcaktuara me aktet e KQZ-së.

Përbërja e komisioneve zgjedhore

Neni 65

Komisionin e zgjedhjeve e përbëjnë kryetari dhe anëtarët e përbërjes së përhershme dhe të zgjeruar.

Përbërjen e përhershme të komisionit të zgjedhjeve e përbëjnë: kryetari dhe më së paku dy anëtarë.

Përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor e përbëjnë nga një përfaqësues i paraqitësve të listave të zgjedhësve. Dy ose më shumë propozues të listave të zgjedhësve mund të caktojnë kandidatin e përbashkët.

Kryetari dhe anëtarët e përbërjes së përhershme të këshillit zgjedhor i kanë zëvendësit.

KQZ e formon këshillin zgjedhor dhe e emëron kryetarin, anëtarët e përhershëm dhe zëvendësit e tyre nga personat të cilët janë regjistruar në listë të veçantë të zgjedhësve.

Kompetenca e këshillit zgjedhor

Neni 66

Këshilli zgjedhor drejtpërsëdrejti e zbaton votimin në qendrën e votimit, e siguron rregullsinë dhe sekretin e votimit, i konstaton rezultatet e votimit në qendrën e votimit dhe ushtron punë të tjera të caktuara me këtë ligj.

Këshilli zgjedhor kujdeset për mirëmbajtjen e rendit në qendrën e votimit gjatë kohës së votimit.

Rregullat më të hollësishme për punën e këshillave zgjedhore i përcakton KQZ.

Qendrat e votimit

Qendrat e posaçme të votimit

Neni 67

Votimi për këshilla kombëtare zhvillohet në qendrat e votimit të cilat i përcakton KQZ.

Përcaktimi i qendrave të votimit

Neni 68

KQZ i cakton qendrat e votimit në të cilat votohet për zgjedhjen e këshillave kombëtare, duke u udhëhequr me numrin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare të cilat jetojnë në zonën në të cilën formohet qendra e votimit, e që janë regjistruar në listën e zgjedhësve.

Qendra e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave kombëtare caktohet nëse në zonën në të cilën formohet qendra e votimit ka më së paku 100, e më së shumti 2.500 votues të regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve.

Lista e qendrave të votimit

Neni 69

Lista e qendrave të votimit në të cilat bëhet votimi për këshillat kombëtare shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Rregullimi i qendrës së votimit

Neni 70

Rregullat lidhur me rregullimin e qendrës së votimit i përcakton KQZ.

Kandidimi – lista e zgjedhësve

Të drejtë kandidimi

Neni 71

Listat e zgjedhësve munden, nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj, t'i propozojnë grupet e zgjedhësve të regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare përkatëse, përkatësisht organizatës, shoqatës së qytetarëve, si edhe organizatat politike të pakicës kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: propozuesi).

Listën e zgjedhësve me nënshkrimet e veta duhet ta mbështesin më së paku 1%, e jo më pak se 50 votues të regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës përkatëse kombëtare.

Organizatë, shoqatë ose organizatë politike e pakicës kombëtare konsiderohet organizata, shoqata e qytetarëve ose organizata politike e cila ka parashenjë të një pakice kombëtare në emërtimin e vet, ose me statut është caktuar si organizatë, shoqatë ose organizatë politike e cila grumbullon, ose vepron në interes të pjesëtarëve të pakicës kombëtare.

Nënshkrimet për përkrahje duhet të jenë të vërtetuar, në pajtim me këtë ligj.

Propozimin nga paragrafi 1, i këtij neni mundet ta paraqesë vetëm personi të cilin e ka autorizuar propozuesi i listës së zgjedhësve.

Lista e zgjedhësve – struktura

Neni 72

Në listën e zgjedhësve gjenden më së shumti aq kandidatë sa anëtarë të Këshillit Kombëtar zgjedhen, e më së paku pesë.

Bartësin e listës së zgjedhësve dhe radhitjen e kandidatëve e cakton propozuesi.

Në listën e zgjedhësve më së paku 30% e vendeve janë rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar, por që secili vend i tretë në listën e zgjedhësve është rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar.

Nëse lista e zgjedhësve nuk i plotëson kushtet nga paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, do të konsiderohet se përmban mungësi për shpalljen e listës së zgjedhësve, kurse propozuesi i listës do të ftohet të mënjanojë mangësitë e listës, në pajtim me këtë ligj.

Nëse propozuesi i listës nuk i mënjanon mangësitë nga paragrafi 4, i këtij neni, KQZ, në pajtim me këtë ligj, do të refuzojë shpalljen e listës së zgjedhësve.

Tërheqja e listës së zgjedhësve

Neni 73

Propozuesi i listës së zgjedhësve mundet të tërheqë listën më së voni deri në ditën e përcaktimit të listës shumëemërore të zgjedhësve.

Me tërheqjen e listës së zgjedhësve pushon anëtarësia e përfaqësuesit paraqitësit të listës në të gjitha organet për zbatimin e zgjedhjeve, si edhe të gjitha të drejtat të cilat në këtë cilësi i takojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Emërtimi, përcaktimi dhe shpallja e listës së zgjedhësve

Neni 74

Lista e zgjedhësve e ka emërtimin të cilin e cakton propozuesi i listës së zgjedhësve.

Emërtimi i listës së zgjedhësve mundet të përfshijë emrin dhe mbiemrin e personit, shoqatës ose organizatës së pakicës kombëtare nga neni 71 i këtij neni të cilën propozuesi e cakton, si edhe emrin e bartësit të listës së zgjedhësve.

Formulari për përkrahjen e listës së zgjedhësve

Neni 75

KQZ e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit për mbledhjen e nënshkrimeve dhe e vë në disponim të pjesëmarrësve në zgjedhje brenda afatit prej pesë ditësh nga shpallja e zgjedhjeve.

Zgjedhësi mundet me nënshkrimin e vet të përkrahë listën e zgjedhësve vetëm të një propozuesi. Secili nënshkrim nga paragrafi 1, i këtij neni duhet të jetë i vërtetuar në gjykatën komunale ose në administratën komunale përkatësisht në zyren e vendit.

Veprimi me listën e zgjedhësve

Neni 76

Lista e zgjedhësve i dërgohet KQZ më së voni 15 ditë para ditës së caktuar për votim.

Bashkë me listën zgjedhore, KQZ-së i dërgohet edhe dokumentacioni, dhe këtë:

- 1) vërtetimi për regjistrim në listën e veçantë të zgjedhësve të pakicës kombëtare për secilin kandidat nga lista e zgjedhësve, në të cilën është shënuar emri dhe mbiemri, datëlindja, profesioni dhe numri profesional i kandidatit;
- 2) deklarata me shkrim e kandidatit se e pranon kandidaturën;
- 3) dëshmia për vendqëndrimin e kandidatit;
- 4) pajtimi me shkrim i bartësit të listës;
- 5) autorizimi për mbledhjen e nënshkrimeve të cilat ia jep Ministria personit i cili e paraqet listën e zgjedhësve;
- 6) në formular të veçantë nënshkrimet e vërtetuara të zgjedhësve të cilët e kanë përkrahur listën e zgjedhësve.

Shpallja e listës së zgjedhësve

Neni 77

KQZ e shpall listën e zgjedhësve të propozuesit menjëherë pas pranimit të listës së zgjedhësve dhe të dokumentacionit shoqërues, e më së voni brenda afatit prej 24 orësh nga pranimi i listës së zgjedhësve.

Aktvendimin për shpalljen e listës së zgjedhësve nga paragrafi 1, i këtij neni KQZ ia dërgon menjëherë propozuesit.

Mangësitë e listës së zgjedhësve

Neni 78

Kur KQZ konstaton se lista e zgjedhësve nuk është paraqitur me kohë, e miraton aktvendimin për refuzimin e listës së zgjedhësve.

Kur KQZ konstaton se lista e zgjedhësve përmban mangësi të cilat e bëjnë të pamundur shpalljen e listës së zgjedhësve, do ta miratojë përfundimin, brenda afatit prej 24 orësh nga data e pranimit të listës së zgjedhësve, me të cilin nga propozuesi i listës së zgjedhësve kërkon që, më së voni brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i dorëzimit të përfundimit, të mënjanojë ato mangësi. Në përfundim propozuesi i listës së zgjedhësve udhëzohet me mënyrën se si të mënjanojë mangësitë.

Kur KQZ konstaton se lista e zgjedhësve përmban mangësi, përkatësisht nëse konstaton se mangësitë nuk janë mënjanuar, ose nuk janë mënjanuar brenda afatit të parashikuar, brenda 48 orësh do të miratojë aktvendimin për refuzimin e shpalljes së listës së zgjedhësve.

Lista shumëemërore zgjedhore

Neni 79

Listën shumëemërore zgjedhore e përcakton KQZ veçanërisht, për secilën pakicë kombëtare.

Lista shumëemërore zgjedhore i përfshin të gjitha listat e zgjedhësve për secilën pakicë kombëtare, me emrat personalë të të gjithë kandidatëve dhe të të dhënave për vitin e lindjes, profesionin dhe vendqëndrimin.

Radhitja e listave të zgjedhësve në listën shumëemërore zgjedhore përcaktohet sipas radhitjes së shpalljes së listës së zgjedhësve.

Listën shumëemërore zgjedhore për secilën pakicë kombëtare KQZ e shpall në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë“, më së voni dhjetë ditë para ditës së votimit. Për ditën e shpalljes së listës shumëemërore zgjedhore merret dita e shpalljes së saj në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë“.

Propozuesi i listës zgjedhore ka të drejtë që, brenda afatit prej 48 orësh nga dita e shpalljes së listës shumëemërore zgjedhore, përmes personave të cilët i autorizon, të njihet me dokumentacionin i cili është paraqitur bashkë me listat e shpallura të zgjedhësve.

Neni 80

Pas mbylljes së listës së veçantë të zgjedhësve, KQZ e shpall numrin e përgjithshëm të zgjedhësve në tërësi, sipas njësive të vetëqeverisje vendore dhe të qendrave të votimit, brenda afatit prej 48 orësh.

KQZ e harton kopjen e vërtetuar të listës së zgjedhësve nga lista e veçantë e zgjedhësve për secilën qendër të votimit.

Kopja nga lista e veçantë e zgjedhësve, përveç të të dhënave nga neni 50 i këtij ligji, përmban emërtimin e organit i cili e ka hartuar, datën e hartimit dhe shenjën e qendrës së votimit për të cilën është hartuar kopja.

Neni 81

Organet republikane, organet e krahinës autonome, organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, institucionet publike dhe organet tjera kanë për detyrë që, me kërkesën e votuesve, menjëherë të lëshojnë dokumentet publike të rëndësishme

për realizimin e të drejtës së zgjedhësve, e më së voni ditën e ardhshme nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 82

Ministria dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë që përfaqësuesve të autorizuar të paraqitësve të listave të konfirmuara të zgjedhësve t'ua bëjnë të mundur të njihen me listën e veçantë të zgjedhësve, si dhe të njihen me dokumentacionin zyrtar në bazë të të cilit organi kompetent për mbajtjen e listës së veçantë të zgjedhësve e bën regjistrimin, shlyerjen, ndryshimet dhe plotësimet ose korrigjimet e listës së zgjedhësve.

Njohja bëhet në ambientet zyrtare të organeve të cilat gjendet dokumentacioni zyrtar.

Neni 83

Sipas parashtresës së paraqitësit të listës së konfirmuar të zgjedhësve, Ministria ka për detyrë të bëjë kontrollin brenda afatit prej 24 orësh nga dita e pranimit të parashtresës.

Ministria ka për detyrë t'ia dërgojë paraqitësit parashtresat, ekzemplarin e procesverbalit për kontrollin e kryer dhe ekzemplarin e aktit me të cilin nga organi kompetent kërkohet të ndërmarrë masa dhe veprime të caktuara, brenda afatit prej 48 orësh nga dita e kryerjes së kontrollit të inspektimit.

Mbajtja e zgjedhjeve

Votimi

Neni 84

Zgjedhësi voton në qendrën e votimit në të cilën është regjistruar në kopjen e listës së veçantë të zgjedhësve.

Jashtëzakonisht, zgjedhësi mund të votojë edhe jashtë qendrës së votimit nga paragrafi 1, i këtij neni sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin për zgjedhjen e deputetëve të popullit.

Mënyra e votimit jashtë qendrës së votimit dhe numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar kështu, shënohet në procesverbalin për punën e këshillit të zgjedhësve.

Informimi i zgjedhësve për votim

Neni 85

Patjetër, secilit zgjedhësi, më së voni pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve i dërgohet njohtimi për ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, me numrin dhe adresën e qendrës së votimit në të cilën voton dhe me numrin nën të cilin është regjistruar në kopjen nga lista e veçantë e zgjedhësve.

Njohtimin nga paragrafi 1, i këtij neni zgjedhësve ua dërgon organi kompetent për mbajtjen e listës së zgjedhësve.

Mënyra e votimit

Neni 86

Zgjedhësi voton personalisht.

Zgjedhësi gjatë mbajtjes së zgjedhjeve mundet të votojë vetëm një herë.

Votimi është i fshehtë.

Votohet në fletëvotimet e vërtetuara.

Në qendrën e votimit dhe në 50 metra nga qendra e votimit ndalohet të theksuarit e materialit propagandistik.

Nëse gjatë votimit shkelen rregullat nga paragrafët 1 deri 4 të këtij neni, këshilli zgjedhor shpërndahet, kurse votimi në atë qendër të votimit përsëritet.

Në qendër të votimit ndalohet përdorimi i celularëve dhe i mjeteve tjera të lidhjes dhe të komunikimit.

Udhëzimet më të hollësishme për masat me të cilat sigurohet fshehtësia e votimit i përcakton KQZ.

Koha e votimit në qendrën e votimit

Neni 87

Qendrat e votimit hapen në orën 7,00 , dhe mbyllen në orën 20,00. Gjatë kësaj kohe qendra e votimit duhet të jetë vazhdimisht e hapur.

Zgjedhësve të cilët janë gjetur në qendër të votimit në momentin e mbylljes u mundësohet votimit.

Gjatë kohës së votimit anëtarët e këshillit zgjedhor ose zëvendësit e tyre duhet të jenë në qendrën e votimit.

Mbajtja e rendit në qendrën e votimit

Neni 88

Nëse në qendrën e votimit prishet rendi, këshilli zgjedhor mundet të ndërprejë votimin derisa nuk vendoset rendi. Shkaqet dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së votimit shënohen në procesverbalin për punën e këshillit zgjedhor.

Nëse votimi është ndërprerë më gjatë se një orë, votimi vazhdohet për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja.

Në hapësirën në të cilën bëhet votimi mund të jetë i pranishëm vetëm numri i aq zgjedhësve sa ka vende të siguruar për fshehtësinë e votimit.

Ndalohet ndalja në qendrën e votimit e personave të cilët, në pajtim me këtë ligj, nuk kanë të drejta dhe detyra lidhur me zbatimin e zgjedhjeve.

Pjesëtarët e policisë në detyrë mund të hyjnë në qendrën e votimit vetëm nëse në qendrën e votimit është prishur rendi dhe paqja, me ftesën e kryetarit të këshillit zgjedhor.

Për shkak të shkeljes së dispozitave të paragrafëve 1 deri 5, të këtij neni mund t'i paraqitet kundërshtimi KQZ-së, i cili vendos a do të përsëritet votimi në atë qendër të votimit.

Materiali për zgjedhje

Gjuha dhe alfabeti i materialit për zgjedhje

Neni 89

Tërë materiali për zgjedhje dhe dokumentacioni shtypen në dy gjuhë, në gjuhën serbe me alfabetin cirilik dhe në gjuhën dhe në alfabetin e pakicës kombëtare Këshilli Kombëtar i së cilës zgjedhet.

Fletëvotimet

Neni 90

Fletëvotimi përmban:

- 1) numrin rendor para emërimit të listës së zgjedhësve;
- 2) emërtimet e listave zgjedhore, sipas radhijtes së përcaktuar në listën shumëemërore zgjedhore, me emrin personal të bartësit të listës së zgjedhësve;
- 3) vërejtjen se votohet vetëm për një listë zgjedhore, me rrebullakësimin e numrit rendor para emërimit të listës.

Fletëvotimet i përgatit dhe i vërteton KQZ.

KQZ e përcakton numrin e fletëvotimeve, i cili duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve.

Fletëvotimet shtypen në një vend, në letër të mbrojtur me shenjë ujore.

Propozuesi i listës së zgjedhësve ia dërgon KQZ-së emrin e personit i cili ka të drejtë të marrë pjesë në shtypjen, numërimin, paketimin e fletëvotimeve dhe dërgimin e tyre organeve kompetente për zbatimin e zgjedhjeve.

KQZ më hollësisht e parashikon formën dhe pamjen e fletëvotimeve, mënyrën dhe kontrollin e shtypjes së tyre dhe dërgimin dhe veprimin me fletëvotimet.

KQZ më hollësisht e parashikon formën dhe dimenzionet e kutisë së votimit. Kutitë e votimit duhet të jenë nga materiali i tejdukshëm.

KQZ ka për detyrë që secili këshill zgjedhor me kohë të përgatisë materialin për votim, e sidomos numrin e nevojshëm të fletëvotimeve, listën shumëemërore zgjedhore, kopjen nga lista e veçantë e zgjedhësve dhe formularin për punën e këshillit zgjedhor.

Pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor e përgatit KZZ më së voni 48 orë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.

KZZ, në bashkëpunim me administratën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kujdeset për rregullimin e qendrave të votimit dhe përgatit për secilin këshill zgjedhor numrin e nevojshëm të kutive të votimit me pajisjet për vulosjen e tyre dhe me pajisjet për shkrim.

Në ditën e votimit, para fillimit të votimit, këshilli zgjedhor përcakton a është materiali zgjedhor për këtë qendër të votimit i plotë dhe i rregullt, a është rregulluar qendra e votimit sipas mënyrës me të cilën sigurohet fshehtësia e votimit dhe a mundet të fillojë votimi. Të dhënat e theksuara shënohen në procesverbalin për punë.

Lista shumëemërore zgjedhore e secilës pakice kombëtare Këshilli Kombëtar i të cilës zgjedhet në qendrën e votimit, me emërtimet e listave të zgjedhësve dhe me emrat e kandidatëve, duhet gjatë kohës së votimit të theksohet në vend të dukshëm në qendrën e votimit.

Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e theksimit të listës zgjedhore e përcakton KQZ.

Përfaqësuesit e propozuesve të listave të zgjedhësve kanë të drejtë të njihen me materialin e zgjedhjeve. Njohja me materialin bëhet në ambientet hapësinore të KQZ-së. Këqyrja e materilaig zgjedhor mund të bëhet në afatin prej pesë ditësh nga data e votimit.

Ruajtja e materialit zgjedhor

Neni 91

Materiali zgjedhor ruhet më së paku katër vjet.

KQZ e parashikon mënyrën e këqyrjes dhe ruajtjen e materialit zgjedhor.

Votimi

Neni 92

Këshilli zgjedhor e verifikon kutinë e votimit në prani të zgjedhësit i cili i pari arrin në qendër të votimit. Me verifikim konstatohet a është kutia e votimit e rregullt, e zbrazët dhe e përshtatshme që të garantojë sigurinë dhe fshehtësinë e përmbajtjes së fletëvotimeve. Rezultati i kontrollit shënohet në listën e kontrollit, të cilën e nënshkruajnë anëtarët e këshillit zgjedhor dhe zgjedhësi i cili i pari ka arritur në vendin ku mbahen zgjedhjet.

Në kutinë e votimit hidhet lista e kontrollit, e pastaj ajo në prani të zgjedhësit të parë vulozet, gjë që shënohet në procesverbalin për punën e këshillit zgjedhor.

Pas hapjes së kutisë së votimit, së pari verifikohet a ekziston në të lista e kontrollit. Nëse në kutinë e votimit nuk ka listë të kontrollit, këshilli zgjedhor shpërndahet dhe emërohet këshilli i ri, kurse votimi në atë qendër të votimit përsëritet.

Formularin e listës së kontrollit dhe mënyrën e vulosjes së kutisë së votimit e përshkruan KQZ.

Rrjedha e votimit

Neni 93

Zgjedhësi e njohton këshillin zgjedhor me emrin e vet personal dhe e dorëzon njohtimin për votim, kurse me letërnjohtim ose me dokument tjetër të rregullt e dëshmon identitetin e vet.

Zgjedhësi nuk mundet të votojë pa paraqitjen e dëshmive për identitetin e vet. Kryetari ose anëtari i këshillit zgjedhor, pasiqë e konstaton identitetin e zgjedhësit, e rrethon numrin rendor nën të cilin është i regjistruar votuesi në kopjen nga lista e veçantë e zgjedhësve dhe ia shpjegon mënyrën e votimit.

Zgjedhësi e nënshkruan listën e zgjedhësve dhe e merr fletëvotimin.

Secilit zgjedhësi i cili e ka filluar votimin dhe e ka marrë materialin për votim, do t'i hidhet prej special në gishtin tregues të dorës së djathtë, si dëshmi se tashmë ka votuar. Shenja në gishtin tregues zgjat më së paku 24 orë.

Anëtarët e këshillit zgjedhor nuk guxojnë në kurrfarë mënyre të ndikojnë në vendimin e zgjedhësit.

Anëtarët e këshillit zgjedhor kanë për detyrë që zgjedhësit, me kërkesën e tij, t'ia shpjegojnë mënyrën e votimit.

Anëtarët e këshillit votues kanë për detyrë që sidomos të kenë kujdes që askush të mos e pengojë votuesin me rastin e plotësimit të fletëvotimit dhe që plotësisht të sigurohet votimi i fshehtë.

Në ditën e zgjedhjeve nuk mund të kryhen kurrfarë ndryshimesh në kopjet nga listat e veçanta të zgjedhësve.

Nëse gjatë votimit shkelen dispozitat e paragrafëve 5 deri 9 të këtij neni, KQZ-ja e shpërndan këshillin zgjedhor, e formon këshillin e ri zgjedhor dhe e cakton përsëritjen e votimit në atë qendër të votimit.

Mënyra e votimit

Neni 94

Zgjedhësi mundet të votojë vetëm për një listë të zgjedhësve. Votohet duke e rumbullakësuar numrin rendor para emërimit të listës së zgjedhësve për të cilën votohet.

Zgjedhësi vetë e palos fletëvotimin ashtu që nuk shihet si ka votuar dhe e vendos në kuti të votimit, e pastaj largohet nga qendra e votimit.

Për votimin jashtë qendrës së votimit konfrom aplikohen rregullat për zgjedhjen e deputetëve të popullit.

Përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve

Përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve në qendrën e votimit

Neni 95

Pas përfundimit të votimit, këshilli zgjedhor e fillon përcaktimin e rezultateve të votimit në qendrën e votimit.

Këshilli zgjedhor e konstaton numrin e fletëvotimeve të papërdorura, i vendos në një mbështjellës të veçantë të cilin e vulos dhe numrin e shënon në procesverbal.

Në bazë të kopjes nga lista e veçantë e zgjedhësve, këshilli zgjedhor e konstaton numrin e përgjithshëm të votuesve të cilët kanë votuar.

Kur hapet kutia e votimit, pas verifikimit të listës së kontrollit, listat e vlefshme të votimit ndahen nga të pavlefshmet dhe numri i fletëvotimeve të pavlefshme shënohet në procesverbal.

Fletëvotim i pavlefshëm është fletëvotimi i paplotësuar, fletëvotimi i cili është plotësuar ashtu që nuk mund të konstatohet për cilën listë zgjedhore ka votuar dhe fletëvotimi në të cilin janë rrethuar më shumë se një listë e zgjedhësve.

Nëse në fletëvotim është rrethuar emri dhe mbiemri i kandidatit të parë në listën e zgjedhësve ose është rrethuar emërtimi ose një pjesë e emërimit të listës së zgjedhësve, përkatësisht, nëse njëkohësisht janë rrethuar numri rendor dhe emërtimi i listës së zgjedhësve dhe emri dhe mbiemri i kandidatit të parë, një fletëvotim i tillë zgjedhor konsiderohet i vlefshëm.

Nëse konstatohet se numri i fletëvotimeve në kutinë e fletëvotimit është më i madh se numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar, këshilli zgjedhor shpërndahet dhe emërohet këshilli i ri, kurse votimi në atë qendër të votimit përsëritet.

Pas përcaktimit të rezultateve të votimit, këshilli zgjedhor në procesverbalin për punën e vet e shënon: numrin e fletëvotimeve të pranuar, numrin e fletëvotimeve të papërdorura, numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, numrin e fletëvotimeve të vlefshme, numrin e votave të dhëna për secilën listë të zgjedhësve, numrin e zgjedhësve sipas kopjes nga lista e zgjedhësve dhe numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar.

Në procesverbalin për punën e këshillit zgjedhor shënohen edhe vërejtjet dhe mendimet e anëtarëve të këshillit zgjedhor, propozuesve të listave të zgjedhësve, si edhe të gjitha faktet tjera me rëndësi për votim.

Procesverbalin për punën e këshillit zgjedhor e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e këshillit zgjedhor.

Procesverbalin për punën e këshillit zgjedhor

Neni 96

Procesverbali për punën e këshillit zgjedhor hartohet në formularin e parashikuar i cili shtypet në gjashtë ekzemplarë.

Ekzemplari i parë i procesverbalit me materialin e zgjedhjeve i dërgohet KQZ-së.

Ekzemplari i dytë theksohet në qendrën e votimit që të mund ta shikojnë publikisht të gjithë.

Katër ekzemplarët tjerë të procesverbalit u dërgohen përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore të cilët e kanë fituar numrin më të madh të votave në atë qendër të votimit dhe këtë menjëherë nëse propozuesi i listës së zgjedhësve e ka përfaqësuesin në këshillin zgjedhor, por nëse nuk e ka, përfaqësuesi i propozuesve të listës së zgjedhësve mundet të marrë ekzemplarin e procesverbalit nga KQZ-ja brenda afatit prej 12 orësh nga përfundimi i votimit.

Propozuesit tjerë të listave të zgjedhësve kanë të drejtë që, brenda afatit prej 12 orësh nga dërgimi i materialit nga qendrat e votimit të KQZ-së, nga KQZ-ja të marrin fotokopjen e vulosur të procesverbalit nga qendra e votimit.

Dërgimi i rezultateve të votimit nga qendra e votimit

Neni 97

Pas konstatimit të rezultateve të votimit, këshilli zgjedhor menjëherë, e më së voni brenda afatit prej 12 orësh nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ia dërgon KZZ-së: procesverbalin për punën; kopjen nga lista e zgjedhësve; fletëvotimet e papërdorura, dhe, veçmas, fletëvotimet e përdorura; të pavlefshme dhe, veçmas, fletëvotimet e vlefshme, si edhe materialin e mbetur të zgjedhjeve.

KZZ, më së voni brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, ia dërgon KQZ-së materialin e zgjedhjeve nga qendrat e votimeve nga zona e vet e votimit.

Brenda afatit prej 72 orësh nga mbyllja e qendrave të votimit, KQZ me procesverbal e konstaton: numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve të secilës pakice kombëtare; numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar në qendrat e votimeve; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pranuar në qendrat e votimeve; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të papërdorura; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të vlefshme; numrin e votave të fituara për secilën nga listat e zgjedhësve.

KQZ i përcakton rezultatet e zgjedhjeve dhe për këtë e harton procesverbalin e veçantë.

KQZ e përcakton përmbajtjen dhe formën e formularit të procesverbalit për punën e vet.

Ndarja e mandateve sipas listave të zgjedhësve dhe pakicave kombëtare

Neni 98

Secilës liste të zgjedhësve i takon numri i mandateve në përpjesëtim me numrin e votave të fituara.

KQZ i ndan mandatet me aplikimin e rregullave të D'Ontovit.

Mandatet ndahen ashtu që numri i përgjithshëm i votave të cilin e ka fituar secila listë e zgjedhësve, për secilin Këshill Kombëtar veçanërisht, ndahet me numrat prej një duke përfshirë edhe numrin e numrit të përgjithshëm të këshillave kombëtare i cili është përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji.

Herësit e fituar ndahen sipas madhësisë, dhe parasysht merren atë herë më të mëdhenj sa anëtarë të Këshillit Kombëtar zgjedhen.

Nëse dy ose më shumë lista të zgjedhësve i fitojnë herësit e njëjtë në bazë të të cilëve ndahet një mandat, e nuk ka më mandate të pandara, mandati do t'i ndahet listës e cila gjithsej e ka fituar numrin më të madh të votave.

Mandatet të cilat i takojnë një liste të caktuar të zgjedhësve u ndahen kandidatëve nga lista sipas radhitjes së cilës emrat e tyre janë theksuar në listë.

Kur listës së zgjedhësve i takojnë më shumë mandate se sa që në atë listë janë propozuar kandidatë për anëtarë të Këshillit Kombëtar, mandati i ndahet listës së zgjedhësve e cila e ka herësin vijues më të madh.

Publikimi i rezultateve të zgjedhjeve

Neni 99

KQZ i shpall në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë“ të dhënat për rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve për Këshillin Kombëtar të secilës prej pakicave kombëtare, dhe këtë për:

- 1) numrin e votuesve të regjistruar në listën e veçantë të zgjedhësve;
- 2) numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të cilët kanë votuar;
- 3) numrin e fletëvotimeve të pranuar;
- 4) numrin e fletëvotimeve të papërdorura;
- 5) numrin e fletëvotimeve të përdorura;
- 6) numrin e fletëvotimeve të paflevshme;
- 7) numrin e fletëvotimeve të vlefshme;
- 8) numrin e votave të cilat i kanë fituar listat e zgjedhësve;
- 9) numrin e vendeve në Këshillin Kombëtar të cilin e ka fituar secila nga listat e zgjedhësve.

KQZ rezultatet e zgjedhjeve i shpall brenda afatit prej 96 orësh nga mbyllja e votimit.

Nga përfundimi i votimit deri te shpallja e rezultateve të zgjedhjeve, KQZ i publikon përmes mjeteve të informimit të dhënat e përkohshme për rezultatet e zgjedhjeve.

Rezultatet e zgjedhjeve shpallen në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë“.

KQZ ia lëshon anëtarit të Këshillit Kombëtar vërtetimin se është zgjedhur.

3. Zgjedhja e anëtarëve të këshillave kombëtare përmes kuvendit elektoral

Dispozitat e përbashkëta

Neni 100

Nëse pakica kombëtare, në pajtim me këtë ligj, nuk i plotëson kushtet për zgjedhjet e drejtpërdrejta, Këshilli Kombëtar e zgjedh Kuvendi i elektorëve të pakicës kombëtare.

Me vendimin për mbajtjen e kuvendit elektoral Ministria e fillon procedurën për zgjedhjen e Këshillit Kombëtar. Vendimi merret brenda afatit prej 15 ditësh nga data kur konstatohet se pjesëtarët e një pakice kombëtare nuk i kanë plotësuar kushtet për zgjedhjet e drejtpërdrejta.

Në vendim caktohet data dhe vendi i mbajtjes së kuvendit elektoral. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve shpallet në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

Data dhe vendi i mbajtjes së kuvendit elektoral publikohet në mjetet e informimit publik, me ftesën publike të gjithë elektorëve që me kohë të paraqesin fletëparaqitjet e plota me shkrim për pjesëmarrje në kuvendin elektoral.

Neni 101

Të drejtë të jetë elektor ka edhe pjesëtari i pakicës kombëtare, të cilin për elektor e ka emëruar organizata ose shoqata e pakicës kombëtare.

Organizatë, shoqatë ose organizatë politike e pakicës kombëtare konsiderohet, organizata, shoqata e qytetarëve ose organizata politike e cila e ka parashenjën e një pakice kombëtare në emërtimin e vet, ose me statut është caktuar si organizatë, shoqatë ose organizatë politike e cila grumbullon, ose vepron në interes të pjesëtarëve të pakicës kombëtare.

Nënshkrimet për përkrahjen e elektorëve duhet të jenë të vulosur në pajtim me këtë ligj.

Propozimin nga paragrafi 1, i këtij neni mundet ta paraqesë vetëm personi të cilin e ka autorizuar propozuesi i listës së zgjedhësve.

Neni 102

Personi i cili ka të drejtë të jetë elektor bashkëlidh:

- 1) fletëparaqitjen elektorale e cila e përmban deklaratën se personi paraqitet për kuvendin elektoral të pakicës kombëtare dhe të dhënat personale;
- 2) vërtetimin për të drejtën elektorale;
- 3) deklaratën me shkrim për përkatësinë kombëtare;
- 4) dëshminë për vendbanimin;
- 5) formularët e plotësuar me 100 nënshkrime të pjesëtarëve të një pakice të caktuar kombëtare.

Personi i cili ka të drejtë të jetë elektor para organizatës ose shoqatës së pakicës kombëtare përveç kushteve të theksuara nga paragrafi 1, i këtij neni e bashkëlidh aktvendimin për regjistrimin e organizatës ose shoqatës dhe dokumentin

me shkrim për vendimin e kuvendit të organizaës ose shoqatës së pakicës kombëtare me të cilin është caktuar për elektor të pakicës kombëtare.

Një pjesëtar i pakicës kombëtare mundet me plotësimin dhe nënshkrimin e formularit të përkrahë vetëm një elektor.

Ministria e parashikon formën dhe përmbajtjen e formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të votuesve të cilët i përkrahin elektorët.

Nënshkrimet mundet t'i mbledhë vetëm kandidati për elektor i cili ka autorizim për mbledhjen e nënshkrimeve të lëshuar nga Ministria.

Neni 103

Fletëparaqitjet me shkrim për pjesëmarrjen në kuvendin elektoral i dërgohen Ministrisë më së voni 30 ditë para mbajtjes së kuvendit elektoral. Ministria ua dërgon ftesën me shkrim në kuvendin elektoral të gjithë elektorëve të cilët i kanë paraqitur fletëparaqitjet e plota.

Në procedurën me të drejtat elektorale aplikohen dispozitat e këtij ligji të cilat e rregullojnë veprimin me listat e zgjedhësve për zgjedhjet e drejtpërdrejta të anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Neni 104

Kuvendi elektoral i zgjedh anëtarët e Këshillit Kombëtar në përpjesëtim me madhësinë e pakicës kombëtare, në pajtim me nenin 9 të këtij ligji.

Mandati i legjislativës së Këshillit Kombëtar fillon nga data e regjistrimit në regjistrin e këshillave kombëtare.

Neni 105

Kuvendi elektoral mund të mbahet nëse në të janë të pranishëm më shumë se gjysma e elektorëve fletëparaqitjet elektorale të të cilëve janë konfirmuar.

Jashtëzakonisht nga paragrafi 1, i këtij neni, kuvendi elektoral nuk mund të mbahet nëse në të nuk marrin pjesë:

- 1) më së paku 20 elektorë të pakicat kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i vogël se 10.000 persona ose nuk është shprehur;
- 2) më së paku 30 elektorë të pakicat kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më shumë se 10.000 persona, por më pak se 20.000 persona;
- 3) më së paku 45 elektorë të pakicat kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më shumë se 20.000 persona, por më pak se 50.000 persona;
- 4) më së paku 60 elektorë të pakicat kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 50.000 persona, por më pak se 100.000 persona;
- 5) më së paku 100 elektorë të pakicat kombëtare numri i të cilave sipas regjistrimit të fundit të popullsisë është më i madh se 100.000 persona.

Neni 106

Punën e kuvendit elektoral, derisa të zgjedhet kryetari i kuvendit elektoral, e udhëheq elektori më i moshuar.

Neni 107

Kuvendi elektoral e fillon punën e vet me përcaktimin e pranisë së elektorëve bashkë me ndihmën e listës së elektorëve të cilën e dërgon Ministria.

Pas përcaktimit të numrit të elektorëve të pranishëm, kuvendi elektoral vazhdon punën e vet me zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarëve, procesmbajtësve dhe anëtarëve të komisionit.

Neni 108

Kuvendi elektoral vendos publikisht, me shumicën e votave të elektorëve të pranishëm.

Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, kuvendi elektoral vendos me votim të fshehtë.

Kuvendi elektoral mundet të vendosë me votim të fshehtë edhe për çështjet tjera, nëse vendos kështu.

Zbatimi i zgjedhjeve

Neni 109

Kuvendi elektoral e zgjedh Këshillin Kombëtar sipas sistemit përpjesëtimor.

Listën e kandidatëve (në tekstin e mëtejme: lista) për anëtarët e Këshillit Kombëtar mundet ta propozojë një e katërta e elektorëve të pranishëm.

Në listën e zgjedhësve më së paku 30% të vendeve janë të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar, dhe secili i treti vend në listën e zgjedhësve është rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar.

Elektori me votën e vet mund të mbështesë vetëm një listë.

Në list mund të jenë më së paku pesë, e më së shumti aq kandidatë sa anëtarë i ka Këshilli Kombëtar. Radhitjen e kandidatëve e përcakton paraqitësi i listës.

Listën e shpall kryetari i kuvendit elektoral, duke e konstatuar numrin e tyre rendor dhe bartësin.

Elektorët votojnë fshehtëazi, në fletëvotimet që më parë të përgatitura, në të cilat e shënojnë emrin e bartësit, përkatësisht numrin e listës.

Mandatet ndahen me aplikimin e rregullave të D'Ontovit.

Mandatet ndahen ashtu që numri i përgjithshëm i votave të cilin e ka fituar secila listë e zgjedhësve, për secilin Këshill Kombëtar veçanërisht, ndahet me numrat prej një duke përfshirë edhe numrin e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili është caktuar në nenin 9 të këtij ligji.

Herësit e fituar ndahen sipas madhësisë, dhe parasysht merren aq herës më të mëdhenj, sa anëtarë të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare zgjedhen.

Nëse dy ose më shumë lista të zgjedhësve i fitojnë herësit e njëjtë në bazë të të cilëve ndahet një mandat, e nuk ka më mandate të pandara, mandati do t'i ndahet listës e cila gjithsej e ka fituar numrin më të madh të votave.

Mandatet të cilat i takojnë një liste të caktuar të zgjedhësve u ndahen kandidatëve nga lista sipas radhitjes sipas së cilës emrat e tyre janë theksuar në listë.

Kur listës së zgjedhësve i takojnë më shumë mandate se sa që janë propozuar në atë listë kandidatësh për anëtarë të Këshillit Kombëtar, mandati i ndahet listës së zgjedhësve e cila e ka herësin vijues më të madh.

4. Zgjedhja e legjislaturës së re të Këshillit Kombëtar

Neni 110

Pas zgjedhjeve të para të këshillave kombëtare sipas këtij ligji, zgjedhjet e legjislaturave të reja të këshillave kombëtare do të bëhen drejtpërsëdrejti ose përmes kuvendit elektoral.

Nismën për zgjedhjen e legjislaturës së re të Këshillit Kombëtar e fillon kryetari i Këshillit Kombëtar jo më herët se gjashtë muaj, e jo më vonë se tre muaj para skadimit të mandatit.

Nëse kryetari i Këshillit Kombëtar nuk e paraqet nismën më së voni tre muaj para skadimit të mandatit, Ministria do të fillojë nismën për zgjedhjen e legjislaturës së re.

Neni 111

Punën e kuvendit elektoral, deri me zgjedhjen e kryetarit të kuvendit elektoral, e udhëheq kryetari i Këshillit Kombëtar.

Në rast të parandalimit të kryetarit të Këshillit Kombëtar, deri me zgjedhjen e kuvendit elektoral, punën e kuvendit elektoral e udhëheq elektori më i moshuar.

VII. FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR

Neni 112

Këshilli Kombëtar e miraton planin e vet financiar vjetor, raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare.

Në planin financiar vjetor të Këshillit Kombëtar jepen të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e Këshillit Kombëtar për vitin kalendarik.

Plani financiar vjetor miratohet sipas procedurës dhe mënyrës së parashikuar me statutin e Këshillit Kombëtar.

Këshilli Kombëtar, brenda 15 ditësh nga data e miratimit të raportit financiar ose llogarisë përfundimtare, ekzemplanirn e raportit ose të llogarisë ia dërgon Ministrisë.

Shfrytëzimi i mjeteve

Neni 113

Mjetet e fituara, në pajtim me këtë ligj, mund të përdoren vetëm për financimin e shpenzimeve për:

- 1) veprimtarinë e rregullt të Këshillit Kombëtar;
- 2) financimin e punës së institucioneve, fondacioneve, shoqërive ekonomike dhe organizatave themelues ose bashkëfinancues i të cilave është Këshilli Kombëtar, institucioni, fondacioni, shoqëritë ekonomike dhe

organizatat tjera të drejtat themeluese të të cilave pjesërisht ose në tërësi janë bartur në Këshillin Kombëtar.

Në shpenzime të veprimtarisë së rregullt të Këshillit Kombëtar bëjnë pjesë sidomos:

- 1) financimi ose bashkëfinancimi i programit dhe i projekteve në fushën e arsimit, kulturës, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe alfabetëve të pakicës kombëtare;
- 2) shpenzimet për marrjen me qira dhe shfrytëzimin e ambienteve hapësinore të Këshillit Kombëtar;
- 3) fitimet, tatimet dhe kontributet e të punësuarëve në Këshillin Kombëtar;
- 4) honoraret dhe kontributet për punën e kryer për nevoja të Këshillit Kombëtar;
- 5) shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet për udhëtime zyrtare;
- 6) blerja e materialit për zyra dhe pajisjes për punën e Këshillit Kombëtar.

Llojet e mjeteve

Neni 114

Mjetet për financimin e punës së këshillave kombëtare sigurohen nga buxheti i Republikës së Serbisë, buxheti i krahinës autonome dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, donacioneve dhe të të ardhurave tjera.

Neni 115

Shuma e mjeteve nga burimet publike të cilat sigurohen për financimin e veprimtarive të këshillave kombëtare përcaktohen për çdo vit me Ligjin për buxhetin e Republikës së Serbisë, përkatësisht me vendimet për buxhetin e KA të Vojvodinës dhe të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

Mjetet nga paragrafi 1, i këtij neni të cilat sigurohen në buxhetin e Republikës së Serbisë klasifikohen ashtu që 30% ndahen në shuma të barabarta për të të gjitha këshillat e regjistruara kombëtare në Republikën e Serbisë, kurse pjesa tjetër e mjeteve (70%) në përpjesëtim me numrin e pjesëtarëve të një pakice të caktuar kombëtare të cilën e përfaqëson Këshilli Kombëtar, si edhe me numrin e përgjithshëm të institucioneve të asaj pakice kombëtare në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit dhe me vëllimin e aktiviteteve të atyre institucioneve.

Vendimin për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Republikës së Serbisë e miraton Ministria duke pasur parasysh propozimet e këshillave kombëtare.

Mjetet nga paragrafi 1, i këtij neni të cilat sigurohen në buxhetin e krahinës autonome ndahen, në pajtim me vendimin e organit kompetent të krahinës autonome, këshillave kombëtare të cilat e kanë selinë në territorin e krahinës autonome.

Mjetet nga paragrafi 1, i këtij neni të cilat sigurohen në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndahen, në pajtim me vendimin e organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes vendore, këshillave kombëtare të cilat i përfaqësojnë pakicat kombëtare të cilat në popullsinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore e arrijnë më së paku 10% nga popullsia e përgjithshme ose e pakicave kombëtare gjuha e të cilave është në përdorim zyrtar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Financimi i punës së institucioneve të drejtat themeluese të të cilave janë bartur në këshillat kombëtare

Neni 116

Financimi i punës së institucioneve ose organizatave të tjera të drejtat themelore të të cilave, pjesërisht ose në tërësi, janë bartur në këshilla kombëtare bëhet nga burimet e njëjta dhe në bazë të normativave të njëjta nga të cilat janë financuar ato institucione dhe organizata para bartjes së të drejtave themeluese në këshillat kombëtare.

Në kontratën për bartjen e të drejtave themeluese në këshillat kombëtare rregullohen obligimet financiare të themeluesit të mëparshëm ndaj institucionit ose organizatës tjetër themelues i të cilit bëhet Këshilli Kombëtar.

Këshilli Kombëtar mundet të sigurojë mjete plotësuese për punë dhe për veprimtarinë e institucioneve dhe të organizatave tjera të drejtat themeluese të të cilave janë bartur në Këshillin Kombëtar.

Llogaria e Këshillit Kombëtar, obligimet e llogarimbajtjes dhe kontrolli financiar

Neni 117

Këshilli Kombëtar e ka llogarinë.

Këshilli Kombëtar ka për detyrë të mbajë librin e hyrje-daljeve për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet.

Libri i hyrje-daljeve mbahet sipas origjinës, shumës dhe strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet kontabiliteti.

Evidencat e librit të hyrje-daljeve të të ardhurave dhe të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar janë çështje e rishikimit vjetor, në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet kontabiliteti, dhe mund të jenë çështje e kontrollit të organeve kompetente.

Këshilli Kombëtar ka për detyrë të mbajë evidencën e veçantë për pronën e vet.

Personi përgjegjës

Neni 118

Me statutin e Këshillit Kombëtar përcaktohet personi përgjegjës për menaxhimin financiar, paraqitjen e raporteve dhe mbajtjen e librave të Këshillit Kombëtar.

Nëse Këshilli Kombëtar me statut nuk e cakton personin përgjegjës, përgjegjës do të konsiderohet kryetari i Këshillit Kombëtar.

Fondi i buxhetit për pakicat kombëtare

Neni 119

Këshilli Kombëtar merr pjesë në procedurën e ndarjes së mjeteve të fondit të buxhetit për pakicat kombëtare, të cilat ndahen me konkurs publik për financimin e programeve dhe të projekteve në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabeve të pakicave kombëtare.

Fondin e buxhetit për pakicat kombëtare e qeveris Ministria.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 120

Mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës dhe të akteve të këshillave kombëtare në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin, e kryen Ministria.

Këshilli Kombëtar ka për detyrë që ministrisë e cila e kryen mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës dhe të akteve, me kërkesën e tij, brenda afatit prej tetë ditësh t'ia dërgojë të dhënat, tekstet dhe dokumentet e kërkuara.

Për dërgimin e të dhënave, teksteve dhe dokumenteve të kërkuara përgjegjësi mban kryetari i Këshillit Kombëtar.

Neni 121

Ministria kompetente do të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së statutit, dispozitës ose aktit tjetër të përgjithshëm të Këshillit Kombëtar para Gjykatës Kushtetuese, nëse konsideron se ai akt nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjin ose dispozitat tjera republikane.

Organi kompetent i krahinës autonome do të fillojë procedurën nga paragrafi 1, i këtij neni, nëse konsideron se akti nuk është në pajtim me aktin krahinor.

Neni 122

Ministria ka për detyrë të ndalë nga zbatimi aktin e Këshillit Kombëtar për të cilin konsideron se nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjin ose me aktin tjetër, me aktvendimin i cili shpallet në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë”. Ministria do të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së aktit para Gjykatës Kushtetuese, brenda afatit prej pesë ditësh nga data e shpalljes së aktvendimit.

Nëse Ministria nuk e fillon procedurën nga paragrafi 1, i këtij neni, aktvendimi për ndaljen nga ekzekutimi do të pushojë të vlejë.

IX. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 123

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi i cili:

- 1) nuk e zbaton ose kundër dispozitave të nenit 47, të këtij ligji e zbaton regjistrimin ose shlyerjen e zgjedhësit nga lista e veçantë e zgjedhësve;
- 2) përdor të dhëna nga listat e veçanta të zgjedhësve të pjesëtarëve të pakicave kombëtare për qëllime për të cilat kjo nuk është e lejuar me këtë ligj, në kundërshtim me nenin 49, të këtij ligji.

Neni 124

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri më 30.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi i cili në qendrën e votimit e përdor pejxherin, celularin dhe mjetet tjera të lidhjes dhe të komunikimit, në kundërshtim me nenin 86, paragrafi 7, i këtij ligji.

Neni 125

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi i cili shkakton trazira në qendrën e votimit, për shkak të të cilave votimi, në pajtim me nenin 88 të këtij ligji, është dashur të ndërpritet.

Neni 126

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri më 30.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi juridik ose fizik i cili e prish ose e keqpërdor të drejtën për shfrytëzimin e simboleve kombëtare.

Neni 127

Me dënimin me gjobë prej 500 deri 50.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në këshillin kombëtar, nëse:

- 1) nuk vepron sipas nenit 6, paragrafi 3 i këtij ligji;
- 2) në kundërshtim me dispozitat e nenit 120 paragrafi 2, brenda afatit prej tetë ditësh nga data e dërgimit të kërkesës, nuk ia dërgon Ministrisë e cila e kryen mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës dhe të akteve të dhënat, tekstet dhe dokumentet e kërkuara.

Neni 128

Me dënimin me gjobë prej 50.000 deri 200.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje Këshilli Kombëtar, nëse:

- 1) brenda afatit prej 30 ditësh nga data e miratimit të ndryshimeve dhe të plotësimeve të statutit, nuk e njohton Ministrinë për këtë dhe nuk i dërgon ndryshimet dhe plotësimet e statutit, si edhe procesverbalin nga seanca në të cilën janë aprovuar;
- 2) në kundërshtim me dispozitat e nenit 120, paragrafi 2 brenda afatit prej tetë ditësh nga data e dërgimit të kërkesës nuk ia dërgon ministrisë e cila e bën mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës dhe të akteve të këshillave kombëtare të dhënat, tekstet dhe dokumentet e kërkuara.

IX. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 123

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi i cili:

- 1) nuk e zbaton ose kundër dispozitave të nenit 47, të këtij ligji e zbaton regjistrimin ose shlyerjen e zgjedhësit nga lista e veçantë e zgjedhësve;
- 2) përdor të dhëna nga listat e veçanta të zgjedhësve të pjesëtarëve të pakicave kombëtare për qëllime për të cilat kjo nuk është e lejuar me këtë ligj, në kundërshtim me nenin 49, të këtij ligji.

Neni 124

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi i cili në qendrën e votimit e përdor pejxherin, celularin dhe mjetet tjera të lidhjes dhe të komunikimit, në kundërshtim me nenin 86, paragrafi 7, i këtij ligji.

Neni 125

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi i cili shkakton trazira në qendrën e votimit, për shkak të të cilave votimi, në pajtim me nenin 88 të këtij ligji, është dashur të ndërpritet.

Neni 126

Me dënimin me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarësh do të dënohet për kundërvajtje personi juridik ose fizik i cili e prish ose e keqpërdor të drejtën për shfrytëzimin e simboleve kombëtare.

Neni 127

Me dënimin me gjobë prej 500 deri 50.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në këshillin kombëtar, nëse:

- 1) nuk vepron sipas nenit 6 paragrafi 3 i këtij ligji;
- 2) në kundërshtim me dispozitat e nenit 120 paragrafi 2 brenda afatit prej tetë ditësh nga data e dërgimit të kërkesës, nuk ia dërgon Ministrisë e cila e kryen mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës dhe të akteve të dhënat, tekstet dhe dokumentet e kërkuara.

Neni 128

Me dënimin me gjobë prej 50.000 deri 200.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje Këshilli Kombëtar, nëse:

- 1) brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të statutit, nuk e njohton për këtë Ministrinë dhe nuk i dërgon ndryshimet dhe plotësimet, si edhe procesverbalin nga seanca në të cilën janë aprovuar;
- 2) në kundërshtim me dispozitat e nenit 120, paragrafi 2, brenda afatit prej tetë ditësh nga dita e dërgimit të kërkesës, nuk ia dërgon ministrisë e cila e kryen mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës dhe të akteve të këshillave kombëtare të dhënat, tekstet dhe dokumentet e kërkuara.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 129

Brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ministri e miraton vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për këshillat kombëtare.

Nga dita e shpalljes deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve nga paragrafi 1, i këtij neni nuk mund të kalojnë më pak se 60 as më shumë se 90 ditë.

Kuvendi elektoral do të mbahet brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë, as më i gjatë se 90 ditë nga dita e miratimit të vendimit nga neni 100 paragrafi 2.

Mënyra e zbatimit të zgjedhjeve do të caktohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 130

Këshillat Kombëtare kanë për detyrë që, brenda afatit prej tre muajsh nga data e konstituimit të tyre, të miratojnë statusin e ri ose statutin ekzistues dhe aktet e përgjithshme të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji.

Neni 131

Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e dhënies së propozimeve ose mendimeve në procedurën e zgjedhjes, përkatësisht emërimit të anëtarëve të organizmave të cilët i emëron Republika e Serbisë, krahina autonome ose njësia e vetëqeverisjes lokale, do të aplikohen nga procedura e parë e ardhshme për zgjedhjen, përkatësisht emërimin e anëtarëve të këtyre organizmave.

Neni 132

Ministria do të emërojë përbërjen e përhershme të KQZ-së brenda afatit prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 133

Dispozitat nga neni 4, paragrafi 4, i nenit 52, paragrafi 3, i nenit 55, i nenit 102, paragrafi 4, i këtij ligji, Ministria do të miratojë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 134

Bordi ekzekutiv i Lidhjes së komunave hebreje të Serbisë i kryen funksionet e Këshillit Kombëtar, kurse kryetari i Lidhjes së komunave hebreje i Serbisë është anëtar i Këshillit të Republikës së Serbisë për pakicat kombëtare.

Neni 135

Nëse Këshilli Kombëtar nuk i përcakton emërtimet tradicionale nga neni 22, i këtij ligji brenda afatit prej tre muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, emërtimet tradicionale do t'i përcaktojë qeveria, përkatësisht organi kompetent i krahinës autonome, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e pakicave kombëtare dhe ekspertët për gjuhë, histori dhe gjeografi të pakicave kombëtare.

Dispozitat nga paragrafi 1, i këtij neni nuk kanë të bëjnë me këshillat kombëtare të cilat emërtimet tradicionale nga neni 22, i këtij ligji do t'i përcaktojnë dhe publikojnë para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 136

Ministria mundet për disa zgjedhje të lejojë që vendbanimi si kusht për shfrytëzimin e të drejtës aktive ose pasive elektorale të zëvendësohet me kushtin e vendbanimit, nëse është fjala për personat me vendbanim në rajonin e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Neni 137

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji kryhet zgjedhja e përgjithshme, përkatësisht rizgjedhja e të gjitha këshillave kombëtare.

Nëse në ditën e shpalljes së zgjedhjeve për këshilla kombëtare, Këshilli Kombëtar nuk e ka mbaruar gjysmën e mandatit, mandati i tij përsëritet dhe do të zgjasë aq sa edhe mandati i këshillave kombëtare të cilat zgjedhen.

Këshillat Kombëtare të cilat janë zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, e mandati i të cilave ka skaduar, vazhdojnë të punojnë deri me zgjedhjen, përkatësisht konstituimin e këshillave kombëtare sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 138

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë të vlejshme:

- 1) Neni 24, i Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Pakicave Kombëtare („Fletorja zyrtare e RFJ“, nr. 11/02);
- 2) Rregullorja për Mënyrën e Punës së Kuvendit të Elektorëve për Zgjedhjen e Këshillave të Pakicave („Fletorja zyrtare e RFJ“, nr. 41/02).

Neni 139

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga data e shpalljes në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë“